



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo – Territoriale

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2025, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Arbjan Mazniku – bashkëkryetar i Komisionit

Luçiano Boçi – bashkëkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e sekretarit të komisionit”.
2. Shqyrtimi i projektkalendarit të punës së komisionit.
3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e numrit të ekspertëve pranë komisionit”.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Arbjan Mazniku, Luçiano Boçi, Blendi Klosi, Damian Gjijnuri, Ermal Pacaj, Marjana Koçeku, Klevis Jahaj, Jorida Tabaku, Bledjon Nallbati, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Edmond Haxhinasto, Etleva Budini, Aulona Bylykbashi dhe Agron Malaj.

Mungojnë:

Romina Kuko, Ermal Elezi, Vangjel Dule dhe Enno Bozdo.

HAPET MBLEDHJA

Arbjan Mazniku – Të nderuar kolegë, ju falënderoj shumë për prezencën në këtë takim të parë të plotë dhe i dyti pas konstituimit të komisionit, ku do të kemi mundësi që të fillojmë punën praktike për këtë reformë, që, ndoshta, është një ndër reformat më të rëndësishme, me impakt në jetën e njerëzve në të gjithë territorin, që është reforma administrativo-territoriale. Kemi bërë një sërë diskutimesh paraprake për mënyrën sesi do të ecim para, ndaj mendoj se është momenti i duhur që të fillojmë dhe të diskutojmë në mënyrë praktike për modalitetet e punës së komisionit. Ne të gjitha palët kemi dhënë mjaftueshëm mesazhe, duke shprehur gatishmërinë që të punojmë bashkërisht, të komunikojmë me njerëzit, me qytetarët, me kryetarët e bashkive, me anëtarët e Këshillit Bashkiak, me të zgjedhurit në nivel qarqesh, për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme për të ofruar një strukturë të qeverisjes vendore efektive dhe të dobishme për qytetarët.

Një komision bipartizan, si ky, sigurisht që do të ketë momente të shpeshta, ku nuk do të biem dakord dhe është më se normale që të kemi një diskutim, por e rëndësishme është të kemi diskutime, të bëjmë biseda, të dëgjojmë njerëzit, më pas të gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme.

Sot në rendin e ditës kemi 4 pika:

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Ju përshëndes dhe i uroj suksese komisionit!

Ky është takimi i parë i përbashkët, sepse në mbledhjen e parë opozita nuk ka qenë prezente, nuk ka qenë një dëshirë bojkoti, por ka qenë një akt simbolik i reagimit ndaj kufizimit të hapësirës parlamentare të opozitës nga ana e mazhorancës. Ne kemi vullnetin dhe dëshirën e plotë për të vijuar një reformë që është reformë mbi reformë, për të pasur rezultate konkrete, në raport me atë që sot e kërkon qytetari, e kërkojnë edhe vetë bashkitë, pushteti vendor, për shkak të situatës në të cilën gjenden.

Për të sqaruar edhe opinionin publik, ne jemi këtu për interesin e qytetarëve për të realizuar funksionin dhe detyrën tonë politike.

Dua të them diçka shumë të rëndësishme. Pse bëhet kjo reformë dhe pse është ngritur ky komision? Kush na ka sjellë, në fund të fundit, këtu, sepse ka shumë interpretime dhe duket sikur ne jetojmë vetëm në gjendje reforme?! Kemi pasur reformë para 10 vjetësh në shumë

drejtime; tani kemi reformë mbi reformë dhe arsyet e vërteta pse ne jemi ulur këtu, nuk transmetohen, fshihen sipas përcaktimeve që është kërkesë e BE-së.

Shqipëria po bëhet gati të hyjë në BE dhe normal që duhen standarde nga pushteti lokal. Në të vërtetë arsyeja për ta realizuar këtë reformë, në radhë të parë, nuk është BE-ja, por dështimi spektakolar i reformës së vitit 2015. Nisi si një reformë që do ta modernizonte pushtetin lokal dhe u shndërrua në një centralizim brutal, duke i hequr kompetencat pushtetit lokal dhe duke çuar në një mosfunksionim të qeverisjes vendore në shumë territore dhe në rezultate, në raport me shërbimet ndaj qytetarëve, që sot janë të prekshme, por ndaj të cilave ka edhe qëndrime të caktuara nga qytetarë, përfaqësues të Bashkimit Europian apo përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë që merren me qeverisjen vendore.

Ta themi hapur fare: ne po bëjmë një reformë mbi reformë dhe kam frikë se do të dëgjojmë të njëjtat fjalë. Unë kam qenë prezent në reformën e vitit 2015 dhe mundohem t'u referohem parashtrimeve që janë bërë: modernizim; ndarje territoriale efikase; shërbime ndaj qytetarit; forcim i bashkive në aspektin e funksionit financiar, administrativ; shërbime publike më të mira; zhvillim i ekuilibruar i territorit. Këto fjalë që u hodhën atëherë, që ishin synim i asaj reforme, sot rezultojnë të kundërta. Shumë bashki rurale u gëlltitën nga qendrat e mëdha urbane, pra humbi përfaqësimi i tyre; komunat u shkrinë, pati ndërprerje të përfaqësimit dhe të komunikimit me qytetarët, pasi komunat realizonin komunikimin e përditshëm me qytetarët dhe krijohej një disekuilibër zhvillimor ndërmjet bashkive. Bashkitë e mëdha, për shkak edhe të mundësive që kanë, kanë ecur më shumë përpara sesa shumë bashki të tjera të vogla. Pra, jemi përpara një realiteti të tillë.

Kemi një kërkesë që vjen nga njerëzit për shërbimet e munguara, situatën e rënduar, kryesisht të bashkive të vogla. Meqenëse unë e përmenda, por nuk është arsyeja kryesore, patjetër që ka interes edhe nga BE-ja nëpërmjet organizmave të saj, gjithashtu, ka shqetësim shumë të madh për atë që quhet autonomi e pushtetit lokal dhe e kompetencave të tij, pra ky është shtrati dhe këtë shtrat duhet ta pranojmë.

Kam një këshillë nga përvoja ime politike: në qoftë se ne ecim në po të njëjtat modalitete; në të njëjtat rrugë, siç kemi ecur te reforma e parë, nuk po bëjmë gjë tjetër veçse po bëjmë reformën e reformës së dështuar, që normal do të ketë një rezultat, sikurse kjo reformë, që sot është e dështuar, dhe kam frikë se pas 10 vjetësh mund të bëjmë reformën e reformës që reformoi reformën e dështuar. Tautologji duket, nga ato që i prodhojnë përfaqësuesit tuaj të qeverisë në momente të caktuara, por që lidhet edhe me një të vërtetë. Në qoftë se ne nuk e pranojmë këtë të vërtetë dhe nëse nuk e nisim këtë bashkëpunim mbi këtë

shtrat të së vërtetës, atëherë kam frikë që rezultati i kësaj reforme është i paragjykuar, është i paravendosur, i cili në terma të përgjithshëm është artikuluar, lidhet me reformën zgjedhore, por ndaj të cilit duhet të jemi të frenuar. Në qoftë se duam një produkt, të nisim të punojmë me vërtetësi për atë që unë e thashë: për interesin qytetar dhe për interesin e bashkive.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, patjetër, edhe kryetarët e bashkive kanë interes. Mos mendoni se na i kanë sjellë ata këto. Unë i kam parë se sa të përlurur janë në raport me Kryeministrin, me pushtetin qendror në këtë rast, sepse janë të zhveshur nga çdo lloj autonomie apo pavarësie në menaxhimin e territoreve të tyre. Ajo që kërkohet në thelbin e kësaj reforme, që është thirrja që ka sunduar ligjërimin politik në raport me pushtetin vendor, është një ndarje e re territoriale, më shumë bashki, më shumë shërbime. Kjo është kërkesa reale që ne ndeshim dhe e kemi ndeshur përgjatë fushatave elektorale, pasi kjo ndarje nuk përkon me dëshirën, me tendencat e zhvillimit ekonomik, me vazhdimësinë gjeografike të territoreve të tëra apo me konstitucionin shpirtëror të zonave të caktuara, ku janë prishur, janë ndërfutur dhe kjo reformë që e kishte të bukur fjalorin, siç do ta ketë edhe tani, të përfundojë në një hartë politike, ku vijat e hartave u vendosën në bazë të numrit të votave. Nuk e përcaktoi hartën interesi i bashkive, interesi i qyteteve, por e përcaktoi numri i votave, dhe këtë duhet ta shmangim në mënyrë absolute. Ne jemi këtu për të bashkëpunuar, por jo për të thënë që ne jemi bashkë për një konkluzion që ju e keni parapërgatitur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, e thashë dhe e përsëris, sepse kjo më intereson, i intereson edhe opinionit publik: jemi në funksion të detyrës sonë për ta bërë, pse jo, edhe debatin në shërbim të qytetarit, duke mos pranuar një ndarje politike të njëjësive bashkiake, duke u përpjekur që atyre njëjësive, që do të riformohen, t'u kthejmë autoritetin, kompetencat dhe gjithçka që duan të kenë në dispozicion, për të ushtruar një detyrë që ka një rezultat real konkret në shërbim të qytetarëve.

Ju falënderoj dhe ju uroj suksese!

Fjalën mund ta marrin edhe kolegët e mi, sepse mungesa në mbledhjen e parë ka bërë që të rritet paksa edhe dëshira për t'u prononcuar për këtë komision.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit, zoti Boçi!

Kam dy komente të shkurtra. Meqenëse një pjesë të diskutimeve paraprahe i zhvilluam në mbledhjen e parë, besoj se bën sens, edhe për logjikën e arsyes pse është krijuar komisioni,

por edhe të frymës që duhet bërë, dhe është e udhës të themi dy fjalë më shumë edhe për ta strukturuar në lidhje me disa prej gjërave që ju ngritët.

Së pari, në mënyrë sistematike do të tentoj të evitoj futjen menjëherë të këtij diskutimi në hulli politik. Pa dyshim, secili nga ne ka një pozicion politik dhe, sigurisht, ju jeni në të drejtën tuaj të mendoni gjërat që dëshironi për reformën e vitit 2014, por gjëja që duhet të bëjë një komision si ky, për mendimin tim, edhe ju i referuat ca gjëra në fjalën tuaj, është që ne të bazohemi në fakte, shifra dhe të bazohemi në mënyrë sistematike në eksperiencën e qytetarëve në terren. Bën shumë sens që njerëzit të kenë opinione politike; është shumë normale, por të gjitha të dhënat tregojnë në mënyrë sistematike që reforma e vitit 2014 ka përmirësuar në mënyrë masive të gjithë mënyrën e funksionimit të pushtetit vendorë në vend. Të imagjinojmë 1 sekondë se si do të ishte qeverisja vendore sot në Shqipëri, me sfidat që ka pushteti vendor, nëse ne do të kishim akoma 373 bashki dhe komuna me copëza, ku nuk bënin dot as punët më bazike, as pastrimin e qytetit, as riparimin e një rruge, pra nuk do të bënin asnjë nga punët më bazike funksionale të tyre. Do t'ju jap vetëm një shifër. Në vitin 2014 më shumë se 70% e fondit të shpenzimeve totale të bashkive shkonte për pagat, sot shkon më pak se 43% e buxhetit dhe ky është fakt. Pra, nga 70% e buxhetit tani shkon 43% e buxhetit, pra opinionet janë opinione dhe faktet janë fakte.

Në vitin 2014 bashkitë merrnin më shumë se 67% të fondeve nga qeveria dhe 37% i kishin të ardhurat e tyre, sot 51% i kanë nga të ardhurat e tyre dhe 49% nga qeveria. Totali i sasisë së parave që jep qeveria nëpërmjet ligjit që ka miratuar në Parlament, është 1% e prodhimit të brendshëm bruto, që është një normë shumë herë më e madhe dhe e siguruar, pra totali i shpenzimeve të bashkive është 2,4 herë më e lart sesa ka qenë, që do të thotë se kemi një seri të dhënash sistematike që na tregojnë se nga ana financiare, nga ana e kompetencave, pra nga ana e administrimit bashkitë janë fuqizuar, por kjo është një çështje që ne përsëri mund ta diskutojmë. Unë besoj se në ndër pikat kryesore që duhet të bëjmë është të ulemi dhe të bëjmë një analizë të qenësishme të bazuar në fakte dhe në shifra, jo në opinione politike, për efektivitetin e reformës. Sigurisht, mund të kemi pikënisje të ndryshme se si mund ta shikojmë gjënë, por numrat janë numra dhe faktet janë fakte, ndaj të diskutojmë bazuar në faktet. Diskutimi politik, për fat të keq, jo rrallë herë na çon në një hulli të gabuar. Diskutimi që na duhen më shumë bashki, që të marrim e të fitojmë më shumë bashki, e kthen diskutimin nga një çështje e ofrimit të shërbimit të qytetarëve në një çështje elektorale. Kështu që, mendoj, duke qenë dakord me ju në thelb, ta lëmë këtë si pikë të fundit. Pa dyshim, integrimi evropian

është çështja më e rëndësishme që ne diskutojmë, 70% e *acquis communautaire* zbatohet në nivel vendor dhe rajonal.

Pra, teksa ne jemi në një proces shumë aktiv të angazhimit të nivelit qendror, për të negociuar kapitujt e procesit të integritit europian, që janë hapur të gjithë brenda vitit, dhe për t'i mbyllur brenda vitit 2027, një pjesë e madhe e këtyre rregullave, ligjeve dhe institucioneve që krijohen, zbatohen në nivel vendor. Ne duhet që, paralelisht me këtë proces që ndodh në nivel qendror, të kemi një proces po kaq aktiv të ndodhë në nivel vendor, për të pasur bashki të afta të funksionojnë në këtë proces. Dy programet më të rëndësishme të mbështetjes së vendeve që bëhen anëtare, programi i kohezionit dhe fondet strukturore përsëri lidhen ngushtësisht me kapacitetet që kanë bashkitë e rajonit për të thithur financime nga Bashkimi Europian. Padyshim që ne kemi nevojë për bashki të forta e të afta të funksionojnë jo thjesht si bashki të Republikës së Shqipërisë, por si bashki që funksionojnë brenda një kuadri europian, që dinë të funksionojnë me Brukselin, që dinë të bëjnë projekte, që dinë të tërheqin fonde nga Brukseli, që dinë t'i zbatojnë ato projekte siç duhet, e që përveç financimeve vendore, veç financimeve që vijnë nga buxheti i shtetit, të kenë mundësi të shtojnë financime që vijnë nga Brukseli për komunitetin e tyre. Kjo është një çështje që lidhet ngushtësisht me burimet njerëzore, lidhet ngushtësisht me demografinë, lidhet ngushtësisht me financat vendore.

Fryma që duhet të përhapim të gjithë bashkërisht, është të mos merremi sot me çështjen e numrit, por të merremi me çështje që kanë të bëjnë me kompetencat dhe me mundësitë që kanë bashkitë për t'i ushtruar kompetenca. Mundësitë lidhen me dy gjëra: lidhen me financat që kanë në dispozicion; lodhen me burimet njerëzore të afta për t'i ushtruar këto kompetenca.

Po të nisemi nga ky ushtrim, më pas elementët e numrit do të dalin vetë në mënyrë të natyrshme, nëse i referohemi pyetjes se për çfarë shërbimesh kanë nevojë qytetarët, çfarë shërbimesh kanë nevojë të kenë pranë, dhe çfarë burimesh financiare duhet të kenë institucionet bashkiake për të ofruar këto shërbime.

Unë dua ta vijojmë mbledhjen e komisionit bazuar te një parim shumë i rëndësishëm, që është parimi i subsidiaritetit i Bashkimit Europian, por edhe i pushtetit vendor në përgjithësi, i cili thotë: shërbimet duhet t'i ofrohen qytetarit sa më afër që të jetë e mundur, aty ku është e mundur të ofrohet shërbimi. Çuarja e një shërbimi afër qytetarit thjesht për ta lënë në letër pa ia ofruar, nuk quhet ofrim shërbimi. Ne duhet ta ofrojmë sa më shumë që është e mundur për qytetarin, kudo që të jetë e mundur të ofrohet shërbimi. Nëse u qëndrojmë këtyre parimeve, së bashku mund të realizojmë një proces shumë të mirë.

Unë besoj se nga këndvështrimi i procesit, që do ta diskutojmë edhe pak më vonë, duhet të marrim kohën e nevojshme si komision, të shkojmë e të dëgjojmë njerëzit, e të bëjmë diskutime të mirëfillta, reale me kryetarët e bashkisë, me të zgjedhurit vendorë, me anëtarët e këshillit bashkiakë, me qëllim që të kuptojmë problematikat e njerëzve, të marrim praktikat më të mira europiane në lidhje me këtë proces, si dhe të shohim në kohë, e jo 2 vjet, jo 2027-ën, jo 2031-shin, por të shohim për të krijuar një reformë, e cila t'i qëndrojnë kohës dhe ofrimit të shërbimit ndaj njerëzve. Unë besoj se me këtë frymë mund të gjejmë plot hapësirë për të bashkëpunuar e për të parë interesat më të mira të Shqipërisë.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Zonja Tabaku

Luçiano Boçi – Edhe diçka doja të shtoja. Më fal, Jorida!

Në qoftë se situata do të ishte kaq e lumtur siç e përshkruat ju sot, nuk do të kishim komision për reformën territoriale, por do të kishim duartrokitje për reformën territoriale. Jemi këtu sepse reforma ka dështuar, ka dështuar edhe shërbimi ndaj qytetarëve. Ka distancë mes shërbimeve dhe marrjes së tyre në shumë territore. Bashkitë nuk kanë pavarësi financiare. Ky është realiteti. Unë do të lë kolegët e mi të shprehen në formë më konkrete, sepse ata kanë përvojat e tyre, por po i referohem vetëm autonomisë financiare. Sot bashkitë i kanë sytë te buxheti që u jep qeveria, sepse nuk u është lënë fare hapësirë që të krijojnë të ardhurat e veta financiare, që të investojnë sipas prioriteteve të territoreve e të zonave ku ato veprojnë e ku ka më shumë nevojë. Po i referohem vetëm një elementi shumë të rëndësishëm. Përmendët *acquis*, përmendët parimin e bashkëpunimit midis pushtetit lokal e njerëzve, dhe në lidhje me këto një rezultat fundor. Nëse këto të dyja do të ishin kaq funksionale, sot Shqipëria nuk do të kishte humbur 40 % të popullsisë. Tmërr më i madh është se kjo popullsi është humbur nga bashkitë që konsiderohen përtej Tiranës e përtej qyteteve të mëdha. Kjo ka ardhur për shkak të dështimit të kësaj reforme, sepse qytetari nuk e merr shërbimin në territorin ku ndodhet, arsye për të cilën është i detyruar të largohet nga ai territor. Nëse ka një arsye ndër arsytet madhore, që ka shkaktuar zbrazjen e Shqipërisë në 40 % të saj, me më shumë se 1 milion shqiptarë të ikur, është mënyra e funksionimit të pushtetit lokal. Asnjë akses, asnjë mbështetje, asnjë shërbim. Normale pastaj që qytetari ikën. Domethënë, probabiliteti i një qytetari që jeton në Tiranë për t'u larguar nga Shqipëria, me probabilitetin e një qytetari që jeton në Cërrik apo në Gramsh, është më i vogël. Kjo për arsye se këtu është tjetër gjë, ka higjienë, shërbime, gjërat në një masë të caktuar, ndonëse në masën që dëshiron, se performanca nuk është aq e lartë. Ndërkohë, ai tjetri largohet. Pra, çfarë shifrash të tjera doni ju për ta pranuar që ka dështuar reforma?

Vërtet që ne duhet t'i respektojmë të gjitha direktivat që vijnë nga BE-ja, por kjo nuk do të thotë se direktivat nuk kanë qenë zbatuar edhe kur kemi pasur ndarjen e madhe. Mos iu referoni ndarjes me 300 e ca komuna, sepse parimisht në reformë u ra dakord që të bëhej një ndarje me njësi bashkiake me numër më të vogël, por thashë: ju konkluduat në një reformë politike, me vija politike. Do të doja të kishte variantin e saj, e ka hedhur në tryezë atëherë, por jo me mënyrën si u sollët me atë reformë, të cilën unë e sjell në kujtesë për të parashikuar se s' duhet të silleni me atë lloj forme që u sollët. Pastaj, sa për rezultatet, mjafton kjo shifër. Pastaj kolegët do të sjellin argumentet e tyre.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Zonja Tabaku!

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Mazniku!

Ndjesë, se mbase mund të përsërisim edhe njëri-tjetrin, por besoj se qëllimi është që në mbledhjen e parë të komisionit të shprehim edhe disa mendime, duke pasur parasysh se nuk ishim në mbledhjen e konstituimit, por edhe faktin që kjo është një reformë që Partia Demokratike e ka kërkuar me kohë.

Unë bie dakord me ju e me zotin Boçi, pasi të dy thatë të dy të njëjtën gjë. Fakti që jemi mbledhur këtu, në një komision të reformës territoriale, tregon se së pari reforma e 2015-ës ishte e mangët, sepse nuk u nis nga përgjegjësitë, nga kompetencat dhe nga pushteti lokal, si një pushtet më afër qytetarëve, por u nis nga llogaria elektorale. Llogaritë elektorale jo gjithmonë prodhojnë ndarjen e më të mirë dhe jo gjithmonë reflektojnë atë që kërkojnë sot qytetarët.

Ne jemi njerëz politikë dhe kemi ardhur të gjithë nga një fushatë zgjedhore, ndaj e kemi parë dhe e kemi përjetuar se shërbimet lokale janë larg qytetarëve. Nga ana tjetër, përgjegjësitë dhe kompetencat e pushtetit lokal janë uzurpuar nga qeveria. Kemi kompetenca të pushtetit lokal që nuk respektohen, duke filluar që nga kontrolli i territorit e duke vazhduar me arsimin. Kështu që, kur ju flisni për decentralizimin e për përgjegjësi të bashkive e komunave e për një reformë territoriale që nuk e preku nivelin e tretë të qeverisjes në nivel qarku, unë besoj se ne me të vërtetë duhet t'i referohemi fakteve.

Së pari, unë besoj se ju e kuptoni se reformat e njëanshme dështojnë, dhe reforma që ne po diskutojmë sot këtu ka qenë e njëanshme, ka prodhuar një realitet elektorale për Partinë Socialiste, por jo një realitet për qytetarët. E njëjtë me reformën e pensioneve, e njëjtë me reformën e arsimit. Unë shpresoj shumë që produkti i këtij komisioni të jetë një produkt i përbashkët, në shërbim të asaj që thatë edhe ju: pushteti më afër qytetarëve. Sigurisht,

përgjegjësitë dhe kompetencat e bashkive nga njëra anë, por nga ana tjetër edhe interesin që ne kemi të gjithë për një pushtet, i cili ofron shërbime që sot nuk po i shkojnë qytetarëve.

Së dyti, me sa kuptoj, ne do të kemi një debat të hapur, e kjo është diçka e mirëpritur, sepse procesi i parë i reformës territoriale ka qenë një proces kungulleshkash: unë dua 30 bashki, unë dua 35 bashki. Ka qenë një listë dëshirash nga ana e Partisë Socialiste në atë kohë, sigurisht edhe me mungesën tonë në atë tryezë. Kësisoj, debati i hapur na bën mirë të gjithëve, na bën mirë me kryetarët e bashkive, na bën mirë me qarqet, na bën mirë me të zgjedhurit vendorë, na bën mirë edhe me komunitetet, për të kuptuar nëse shërbimet e bashkive janë të ofruara në çdo komunitet, nëse janë të reflektuara të gjitha realitetet në terren.

Së treti, ju përmendët legjislacionin e Bashkimit European, dhe është e vërtetë se 70 % e legjislacionit të Bashkimit European zbatohet në nivel lokal. Sot jua them me siguri absolute se ndonëse ka pasur një reformë territoriale, bashkitë janë të paafta për ta zbatuar legjislacionin, po edhe për të tërhequr fonde. Ju e dini shumë mirë, falë pozicionit tuaj të mëparshëm, se ekziston një paaftësi në lokal për të aplikuar për projekte jo si rezultat i ndarjes territoriale, por i kapaciteteve lokale, që në këtë rast pjesa më e madhe janë të mazhorancës.

Besoj se ndodhemi në një moment kur ka një ekspertizë lokale, që ka punuar në financa lokale, ka punuar në çështje të përgjegjësisë e kompetencave, por ka punuar edhe në forcimin e bashkive, kjo në kuptimin e përgjegjësisë që kanë sot bashkitë. Unë besoj se këtë ekspertizë lokale duhet ta përdorim dhe të lexojmë të gjitha shifrat e reflektuara atje, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër të përdorim gjithë informacionin që ka ardhur në parlament edhe gjatë diskutimeve të buxhetit, ku një pjesë e madhe e kryetarëve të bashkive, pavarësisht nëse janë të majtë apo të djathtë, ngrejnë shqetësimin në lidhje me faktin se sot 90 % e fondeve që i shkojnë pushtetit lokal janë të përcaktuara. Pushteti lokal nuk ka hapësirë për të marrë vendime për projekte, sepse sot projektet menaxhohen e kontrollohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nuk ka hapësirë as për të bërë politika lokale, as për të trajtuar disa koncepte të zhvillimit ekonomik lokal apo rajonal, të cilët mund të sjellin realitete të tjera.

Kësisoj, unë shpresoj shumë se në fund në ditës do t'i shohim edhe llogaritë elektorale. Në fund të ditës ne do ta shohim edhe reflektimin që kjo do të ketë në llogari elektorale, po për ne si përfaqësues të opozitës interesi i parë janë qytetarët, interesi i dytë është transparenca, dhe interesi i tretë është të bëhet një reformë, e cila të jetë në shërbim të asaj që kërkon sot territori dhe qytetarët.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Po, zoti Boçi!

Luçiano Boçi – Po sikur të them jo tani që ma kërkove fjalën mua?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të vendosim një rregull.

Po, zoti Klosi, fjala për ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Xhelal Mziu – Sikur e kisha radhën unë. Nëse e bëjmë kështu, të flasë kush fut mik, e bëjmë.

Blendi Klosi – Tani, unë e vlerësoj shumë prezencën e opozitës në këtë komision. Në fakt, më pëlqen edhe çfarë po thonë, çka se natyrisht pjesën e parë e kanë kundërshti për faktin se duhet të realizohet ky operacion, po pastaj kur fillohet me argumente, e mbështesin nevojën që ka pasur Shqipëria për një reduktim të madh të numrit të njësive të pushtetit vendor, kjo për shumë arsye. Natyrisht, kryesorja lidhet me lëvizjen demografike të njerëzve, lëvizje migratore dhe emigratore.

Në fakt, unë i përkas grupit që ka qenë në këtë komision edhe në 2015-ën, ku Partia Demokratike mori pjesë, ndërsa nga fundi i tërhoq, u shkëput nga komisioni. Sa mirë do të ishte që të kishim një reformë të plotë që në vitin 2015, të dakordësuar nga të dyja krahët, e në fund fare të kishim një ndarje territoriale të qëndrueshme.

Unë e mbështes atë që tha zoti Mazniku, që ne duhet të bëjmë diçka, e cila t'i qëndrojë kohës jo më vetëm dhjetë vjet, por të ketë mundësi të jetë afatgjatë, të jetë sa më shumë afatgjatë. Është fakt se edhe përfaqësues të opozitës, si në 2015-ën, si sot, nuk kanë qenë kundër reduktimit. Pra, ne nuk mund të shkonim më në një Shqipëri të transformuar me 400 komuna e bashki. Në atë kohë propozimi i krahut të djathtë ka qenë me 100 bashki. Pra, reduktimin me katër herë të njësive të pushtetit vendor e pranonin. Ndërkaq, Shqipëria ndodhet në një fazë tjetër, në një stad tjetër.

Unë e kuptoj që ka debat dhe do të ketë debat gjatë gjithë kohës, por në fund fare neve na duhet të trajtojmë çështjen se sa do të ishte mirë që ky diskutim të ishte pa kamera, sepse kur na vihen kamerat, argumentet politike u mbivendosen argumenteve teknike. Por është fakt, të cilin unë e kam thënë kudo dhe e shpreh me bindje, se nëse ka një kryereformë të bërë në këto vite gjatë të cilëve ne funksionojmë si parlament demokratik, dhe ne si mazhorancë në këto trembëdhjetë vite, ajo është reforma territoriale. Ajo reformë ka transformuar 100 % raportin e qytetarëve pushtetin vendor. A duhet thelluar më shumë? Pa dyshim që duhet thelluar më shumë. Natyrisht, ju ngreni probleme në lidhje me shërbimin, por duhet të marrim argumentet e kohës. Pra, çfarë do të thotë shërbime ndaj qytetarëve, kur tani të gjitha shërbimet

janë online? Tashmë si në qendër të Tiranës, si në qendër të Dibrës, si në qendër të Skraparit, apo si në fshatrat që rrethojnë këto bashki, qytetari e merr shërbimin nëpërmjet sistemeve online, pa pasur më kontakt me pushtetin vendor. Çfarë do të thotë që bashkitë të jenë më të fuqishme? Do të thotë të kenë më shumë investime, të kenë më shumë shërbime, të kenë më shumë gjëra, të cilat as që mund të mendoheshin njëherë e një kohë. A duhet të jetë më i thellë? Pa dyshim që ne do ta diskutojmë. Tani për tani unë nuk kam një përgjigje për këtë pyetje, por nuk diskutohet se duhet të ketë një numër më të reduktuar bashkish, për të krijuar ato bashki që e prezantojnë veten, kanë fuqi shumë më tepër, kanë mundësi për të mbledhur fonde, kanë mundësi për të planifikuar investime, kanë mundësi t'i shërbejnë të gjithë komunitetit që ata kanë brenda territorit të tyre, e jo si në rastin e një numri të madh të bashkive të vogla që janë sot, të cilat kanë shumë pak mundësi t'i shërbejnë komunitetit, krahasuar me bashki pak më të mëdha. Prandaj, kjo është një reformë jashtëzakonisht e rëndësishme. faktet janë shumë kokëforta, treguesit janë shumë kokëfortë, por edhe qytetarët e kanë pranuar, dhe tani të gjithë jemi deputetë terreni, përfaqësues të komuniteteve. As nuk e diskuton më njeri se duhet të kthehemi në situatën e para dhjetë viteve. Me sa e kemi testuar opinionin, e padyshim që komisioni e ka detyrë të ketë shumë më tepër sondim të opinionit publik, të gjithë qytetarët e mirëpresin një thellim të mëtejshëm të kësaj reforme. Megjithatë, kjo është një çështje që do t'u takojë mbledhjeve të ardhshme të komisionit.

Siç ramë dakord në 2015-ën, që nga 400 duhet të bëheshin më pak, ne kërkuam 61, ju kërkuat 100, ju u larguat, inshallah s'largoheni kësaj radhe, duhet të biem dakord që gjënë që kemi për të vendosur, ta vendosim së bashku. Kufijtë territorialë nuk janë të partive. Kufijtë territorialë janë të njerëzve. Për ato kufij ne duhet të biem dakord të gjithë së bashku, dhe njerëzit t'i pranojnë. Sa mirë do të jetë që produkti i këtij komisioni të jetë shumë më i shtrirë në kohë se sa dhjetë vjet.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Faleminderit, zoti Klosi!

Një sqarim që ka të bëjë me parashtrimin tuaj. Ne nuk shprehëm ndonjë kundërshtim pse jemi pjesë e këtij komisioni dhe a duhet një reformë. Madje Jorida tha se reforma ishte një kërkesë e vazhdueshme e Partisë Demokratike, ndërkohë që unë shpreha kundërshti në raport me arsyen e bërjes së kësaj reforme. Nëse ne nuk pranojmë që ajo reformë, s'e pranoni ju, pasi argumentet dhe faktet janë, reforma e 2015-ës ka dështuar, atëherë pse po bëjmë sot një reformë kur ajo qenka kaq e suksesshme? Por meqenëse ju bëtë një parashtrim shumë të suksesshëm, unë po ju jap vetëm një rezultat: po, shumë e suksesshme nga pikëpamja ime, sepse korrupsioni

është endemik, arsye për të cilën sot shumë kryetarë bashkish gjenden para drejtësisë ose në burg. Një nga sukseset më të mëdha të kësaj reforme ishte shtimi i korrupsionit të drejtuesve, për shkak edhe të mënyrës se si konceptojnë menaxhimin e pushtetit lokal dhe mënyrën si funksionon.

Shërbimet online po, janë trendi i kohës, normale që Shqipëria do të ecë me kohën, por kjo nuk do të thotë të largosh njësinë bashkiake nga qytetari, sepse aspekt shumë i rëndësishëm i komunikimit është llogaridhënia. Sot nuk ka llogaridhënie, prandaj dhe ndodhin këto gjëra që unë thashë pak më parë. Po mos të marrim argumente të kundërta. PD-ja u ul në tryezën e 2015-ës, ishte për zvogëlimin e numrit të bashkive, por duke respektuar ato parime e standarde, të cilat i dëgjova edhe sot: forcimi i bashkive në pikëpamje financiare, në pikëpamje të autonomisë, rrije e shërbimit publik, zhvillimi i ekuilibruar i territorit.

Këto u thanë edhe atëherë, por nuk u respektuan, pasi u vendos në bazë të interesave politike të numrit të votave e të bashkimit të votave. Madje, ka raste kur terriore të caktuara janë kafshuar, janë marrë, janë futur, janë bashkuar, sepse llogaria elektorale nuk rezultonte e tillë. Por ajo që më shqetësonte më shumë ishte paragjykimi – gjë që atëherë e thatë si nëntekst ose brenda kontekstit – se duhet një numër më i vogël. Fare, në mënyrë absolute. Në qoftë se ne dalim në këtë konkluzion, atëherë ju i keni vënë minat komisionit, pasi kësisoj paragjykoni rezultatin. Ndërkohë që bini në kundërshtim edhe me kryetarin tuaj, i cili tha se ne do të konsiderojmë shifrat, analizat e shumë aspekte të tjera, e pastaj do të fillojmë të konkludojmë. Është ajo që kërkojmë ne: në qoftë se ka rrugë logjike, ejani të dalim te rruga logjike. Në qoftë se ju keni paravendosur, kjo edhe sipas deklaratave që janë bërë, atëherë edhe ne do t'i shprehim qëndrimet tona.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Ju lutem shumë, edhe për efekt të ecurisë së mbledhjes, bazuar te ajo pak eksperiencë që unë disponoj në lidhje me bashkëdrejtimin e komisionit, që në momentin kur flasin kolegët, asnjë nga bashkëkryetarët nuk ka pse të marrë përsipër monopolin e përgjigjes. Nuk mundet që kur flet një koleg, bashkëkryetari, një nga kryetarët, e këtë s' e kam si debat me zotin Boçi, t'i kthejë përgjigje. Le të flasin njëherë të gjithë, pastaj ju e keni atributin dhe privilegjin, që në fund të drejtoni mbledhjen, ta çoni ku të doni, të bëni edhe konkluzione pasi keni dëgjuar njëri-tjetrin. Pra, ju lutem shumë, kjo nuk është normale, sepse këtu nuk është çështja t'i përgjigjeni çdonjërit prej nesh kur flet, apo e kundërta, zoti Mazniku të kthejë përgjigje. Këtu duhet të flasë secili, e pastaj sigurisht që jeni ju ata që e drejtoni mbledhjen, pasi e keni këtë atribut. Kësisoj, për procedurë, ju lutem, asnjëri të mos reagojë kur flet ndonjëri

nga kolegët. Pastaj, në fund, mund të bëni konkluzionet, dhe debati është i hapur. Këtë kisha si sugjerim. Me sa di fjalën e ka zoti Mziu, e pastaj e kam edhe një herë radhën.

Arbjan Mazniku – Faleminderit, zoti Gjikhuri!

Fjalën e ka zoti Mziu!

Xhelal Mziu – Faleminderit!

Në fakt, unë kam pasur rastin të jem pjesëmarrës në tri reforma gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit, si kryetar bashkie apo i shoqatës së bashkive në vitin 2014. Mbjaj mend vitin 2022, kur e filluam, por nuk e mbyllëm fare, sikundër është edhe kjo që sapo ka filluar sot.

Kujtoj që reforma e vitit 2014, që filloi së funksionuari në 2015-ën, ishte e njëanshme, e cunguar, me disa defekte, të cilat duhet të jenë udhërrëfyesi ynë në këtë moment që ne po diskutojmë për të pasur një pushtet vendor që të jetë afër qytetarëve. Kishte një disproporcion, nuk u respektua proporcionaliteti i shpërndarjes. Unë po ju jap vetëm dy shembuj: bie fjala, qarku i Gjirokastrës ka shtatë njësi vendore. Është sa gjysma e qarkut të Lezhës, që ka vetëm tri njësi vendore. Mesatarisht, një njësi vendore kishte 6 deri në 6, 5 ish-komuna apo bashki të përfituara. Po marr edhe Dibrën, 15 njësi. Pra, kishte një tendencë që në pjesën veriore të Shqipërisë të mos respektohej ky proporcionalitet, e për pasojë nuk është aspekti politik, siç trumbetohet nga ju, por është efekti negativ që ka çuar në shpopullimin, në mbylljen e shkollave, në rrënimin e bujqësisë e në eksodin masiv, gjëra që kanë ndodhur ngaqë shërbimi ndaj qytetarëve është larguar.

Së dyti, dëgjova zotin Mazniku, e jo vetëm sot por edhe në emisione ku ka dalë, që thotë se duhet të kemi bashki të forta. Nuk e kuptoj këtë, pasi asnjë vend në botë nuk e ka si synim që të ketë bashki të forta. Në gjithë botën flitet vetëm për dy standarde: decentralizim, afrimi ndaj qytetarëve, e natyrisht rritja e shërbimeve dhe investimeve.

Absolutisht që ne nuk kemi përdorur asnjë lloj instrumenti. Dua t'ju sjell në mendje faktin që sot Italia, Franca dhe shumica e vendeve të Bashkimit Europian kanë një mesatare prej 9900 banorë për njësi vendore. Ndërsa ne, nëse i referohemi numrit prej 4, 2 milionë banorëve që jemi, i bie ta kemi shtatë herë më shumë. Nëse i referohemi periudhës pas shpopullimit apo eksodit që ka ndodhur, i bie 40 mijë, pra katër herë më shumë.

Po marr edhe një shembull tjetër, Kroacinë, e cila ka po aq banorë sa edhe vendi ynë, 4 milionë banorë. Kemi qenë së bashku me disa kolegë të majtë, e më vjen keq që nuk janë, të cilët kanë qenë edhe ata kryetarë bashkie, ka qenë edhe Bledioni e të tjerë. Kroacia kishte afërsisht 580 njësi vendore. Kishin bërë një reformë ashtu si dhe ne, por ama kishin pasur vetëm një mundësi për të bërë reformën e ndarjes territoriale: duhej që dy apo më shumë bashki të

bashkoheshin vetëm kur të dyja palët ishin dakord që të bashkoheshin, e që kalonin mbi 50 %. Nga 580 njësi qenë reduktuar në 556 njësi. Pra, ata janë 4 milionë dhe kanë 556 njësi, ndërsa ne 4 milionë dhe kishim 373, ndërsa më pas i ulëm në 61.

Kjo do të thotë se ne nuk jemi në rezonancë me atë që ju thoni, zoti Mazniku, që ne po ecim sipas direktivave të Bashkimit Europian. Nuk ka asnjë vend tjetër në Bashkimin Europian, që kryen reformë pa dakordësinë e tyre.

Sot brenda Bashkimit Europian ka bashki edhe me 100 apo 180 banorë, dhe nuk e mundësojnë këtë lloj situatë. Kujtoj se në vitin 2014, kur u bë reforma, kauza kryesore ishte për t'i kursyer buxhetit të shtetit jo pak, por 18 milionë euro, dhe se këto para të kursyera nuk do të shkonin për administratën, por do të përdroreshin për të rritur më shumë shërbimet ndaj qytetarëve. Këtë kauzë ju e keni shkelur me këmbë, sepse nëse para dhjetë vjetësh ishin vetëm 17 mijë të punësuar, sot janë më shumë se 40 mijë të punësuar, pa llogaritur faktin se është dyfishuar niveli i pagës, kjo pothuajse për shkak të unifikimit që iu bë bashkive. Me të drejtë është bërë unifikimi i profesioneve ose i nivelit të pagës sipas bashkive, por ama kauzën që ju kishit nuk e realizuat. Kur ka ekonomi shkalle, kur ka grupim do të thotë se ulet kostoja, po përkundrazi kjo nuk ka ndodhur. Mund t'ju them se sot 54% -55% e buxhetit të bashkive shkon për nivelin e pagës. Madje, mund të themi se në njëfarë mënyre njësitë vendore janë shndërruar në një shtojcë për rritjen e numrit të personave, gjë të cilën do ta kemi objekt bisede më vonë, për të vendosur disa cungime buxhetore. Pra, nuk mundet që një bashki të marrë pa limit persona, gjysma e të cilëve nuk e dinë se ku është vendi i punës, për ta vendosur para përgjegjësisë njësinë vendore.

Një tjetër element, që duhet ta rrëzojë kauzën që ju jeni keni për centralizim, është që edhe ato bashki që nuk kanë kapacitetet e nevojshme financiare, shumica e vendeve të Bashkimit Europian, e me këtë rast po marr si shembull prapë Kroacinë, ka vendosur një fond balancimi. Pra, nga 556 bashki që kishte, caktonte se sa duhej të ishte mesatarja për banorë, e të gjitha njësitë vendore që ishin poshtë nivelit, duke marrë në konsideratë faktin që secila bashki ta kishte përdorur paketën e plotë sipas legjislacionit dhe mbledhjen e debisë që mund të kishin, bëhej dhënia e fondit të balancimit për bashkitë që ndodheshin poshtë nivelit mesatar. Çfarë dua të them me këtë? Dua të them se bashkia nuk është një ndërmarrje që duhet të dalë me fitim, por bashkia duhet të rrisë mbështetjen ndaj qytetarëve, për të qenë sa më afër tyre.

Sot askush nuk mund të thotë se kjo reformë është pozitive, përderisa është larguar ndjeshëm distanca e qytetarëve për të shkuar te qendra e bashkisë, dhe njësitë vendore nuk kanë absolutisht asnjë lloj kompetence e asnjë lloj mundësie për t'u shërbyer qytetarëve.

Ka edhe elementë të tjerë, por unë nuk dua të fokusohem shumë në këtë pjesë. Gjithsesi, ngelet parësor krijimi i proporcionalitetit të këtyre bashkive, rritja e numrit të këtyre bashkive për të shkuar te 90 apo 100 njësi vendore, të cilat do ta afronin më tepër shërbimin. Ngelen edhe financat, të cilat nuk janë vetëm kontributi që ato duhet të japin, por duhet të jetë edhe mbështetja.

Ju folët pak më parë me vlerë, jo me shifra, me përqindje, sepse buxheti i shtetit pothuajse është trefishuar. Pse ju nuk flisni me vlerë? Mua më kujtohet se në vitin 2011-2012, 3, 14 % e buxhetit të shtetit u jepej bashkive, apo më saktë pushtetit vendor, pasi ishin edhe komunat, të cilat ishin me grantin e fillimit të vitit, e pastaj edhe me grante konkurruese. Kjo sot nuk është më, pavarësisht se janë deleguar disa kompetenca, por që janë shndërruar më tepër në kosto shtesë për njësitë vendore, se sa një shërbim për qytetarët.

Ne do të kemi mundësi t'i diskutojmë këto edhe në mënyrë analitike, por nëse ky komision do të ketë fatin e komisionit të vitit 2014, që të bëhet në mënyrë të njëanshme, do të ishte diçka vrastare. Nëse ky komision do të ketë fatin e komisionit të 2022-shit, kur debatuaam mëse nëntë muaj dhe asgjë nuk u arrit, do të ishte skandaloze. Nëse ky komision mblidhet thjesht që t'i shërbejë mazhorancës për ta centralizuar e për t'i shërbyer politikisht, do të ishte po prapë vrastare. Kësisoj, jo vetëm opozita, por as faktori ndërkombëtar nuk është për centralizimin, po kudo flitet për decentralizimin e për t'i shërbyer qytetarëve që janë në gjendje ekstreme. Kujtoj se në Amerikë e në vendet e Bashkimit Europian ftojnë qytetarë nga vendet e tjera, të cilëve u garantojnë shtëpi, e madje edhe pagesë, që të mbajnë gjallë zona të caktuara. Kjo nuk ndodh tek ne për shkak të centralizimit që i është bërë pushtetit vendor. Po të shkosh në të gjitha zonat rurale, flas të paktën për qarkun e Dibrës, që e njoh shumë mirë, janë mbyllur shkollat, nuk ka blegtori, nuk punohen tokat bujqësore, e kjo ngaqë qytetarët kanë ikur, pasi nuk kanë dikë që të mund të shkojë te qendra e komunës që ishte më përpara.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Fjala për zotin Gjiknuri.

Damian Gjiknuri – Faleminderit, zoti Boçi!

Fillimisht ju uroj suksese, meqë është rasti i parë që flas në Komisionin e Reformës Territoriale, përtej asaj ndërhyrjeje që bëra pak më parë. Ky është një komision shumë i rëndësishëm, me një objektiv shumë sublim e jashtëzakonisht të nevojshëm për kohën që kalojmë.

Ne nuk mund ta përcaktojmë fatin e këtij komisioni, nëse vetë ne jemi dyshues në lidhje me objektivat që i kemi vënë vetes. Fatin e bën njeriu vetë, dhe komisioni e përcakton fatin e tij. Eksperienca e komisioneve bipartizane ka treguar se kur kanë pasur bashkëpunim kanë nxjerrë produkt, kur kanë pasur bojkot dhe mohim kanë nxjerrë një produkt që edhe ju vetë e keni kritikuar, paraardhësit tuaj politikë, por edhe disa nga ju këtu, që kemi bërë një gabim të madh në 2014-ën kur bojkotuat komisionin, dhe ne nuk duhet të shkojmë sërish në atë pikë. Motivet nga të cilat jemi nisur nuk përbëjnë as konfirmimin e dështimit, as mohimin e nevojës. Fakti se ka nevojë pas dhjetë vjetësh, e dhjetë vjet janë kohë e mjaftueshme për të rishikuar çdo politikë publike në përgjithësi, gjë që është një standard i njohur. Pse deri në dhjetë vjet, sidomos dhjetëvjetëshi është periudha më se e mirë. Pse? Sepse ka ndryshime demografike, ka ndryshime ekonomike, ka rikonceptim të pjesës urbane, patjetër që ka edhe lëvizje migratore, të cilat e diktojnë një nevojë të tillë.

Sipas mendimit tim, sipas sugjerimit tim, besoj se edhe në programin që kanë paraqitur këtu bashkëkryetarët, që kanë vendosur edhe një *white paper*, një dokument të hapur për diskutim, është shumë e rëndësishme të diskutojmë për metodologjinë. Nuk është çështje pjesëtimi, si ajo shtatë kamionë për 37 batalione, këto historitë që janë tipike për Shqipërinë. Në qoftë se ne vendosim një metodologji nisur nga nevojat për të shtuar kapacitetet e pushtetit vendor, se ne e thamë, ju e thatë, edhe bashkëkryetari i kahut tonë e tha dhe e ka thënë në daljet e tij publike, decentralizimi e pushteti efektiv varen nga sa kapacitete ke për të ofruar, nuk është diçka thjesht në letër. Fillohet që nga burimet njerëzore, nga mundësitë që ke për të krijuar të ardhura. Prandaj është shumë e rëndësishme që ne të vendosim disa standarde të pjesa e metodologjisë. Unë mendoj se tashmë, në këtë fazë, këtu duhet të fokusohet debati. S'kemi pse të fillojmë me idenë e numrave, që kishim nëntëdhjetë atëherë dhe kemi gjashtëdhjetë sot. Kjo nuk ka të bëjë me aspektin elektoral. Ama, në qoftë se duam të shkojmë te rajone më të mëdha, ku mund të ketë një zgjerim më të madh nga pikëpamja elektorale, që lidhet edhe me reformën zgjedhore, kjo është çështje tjetër, por këtu po flasim për njësitë e qeverisjes vendore. Mund të jenë më shumë, mund të jenë më pak, mund të nivele të ndryshme administrimi, llojet e kompetencave, mundësitë e sigurimit të të ardhurave e të tjera, por këto janë gjëra që komisioni duhet t'i trajtojë. Pra, për të hequr ato nevojat e bërjes së shout politik me njëri-tjetrin, le të fokusohemi te metodologjia, tek *white paper*-i, pasi edhe kjo do të jetë e konsultimit publik, në mënyrë që të adresojmë qëllimin që i kemi vënë vetes.

Pra, as nuk është çështje dështimi, as konfirmimi i suksesi, as konfirmimi që nuk ka nevojë. Çdo gjë është dinamike. Jeta dhe qeverisja e një vendi është gjithmonë sipas parimit:

bën përpara, por bën edhe një hap prapa dhe shikon se cilat gjëra nuk kanë shkuar mirë. Kështu ndodh në jetën e njeriut, kështu ndodh në politikën publike të qeverisjes, kështu ndodh në biznes, kështu ndodh në çdo sektor publik, për të bërë një rishikim të gjësë. Mendoj se gjendemi në këtë fazë, ndaj për hir të frymës së këtij komisioni le të fokusohemi pa kaluar te lista e dëshirave. Se çfarë bëjmë pa dashje në këtë rast, gjë që e kam nga eksperiencia? Ne vijmë me disa ide në kokë: unë kam numrin 90, thotë dikush, dhe mbetemi peng i atij numri, e nuk e hapim mendjen për të diskutuar në lidhje me një metodologji, e cila mund të jetë më e pranueshme, nisur nga ato objektiva që synohen. Edhe sa i takon procesit të integritetit evropian, siç e kam dëgjuar nga zoti Mazniku, që e njej fushën, ndaj s'mund të mos e marr me seriozitet atë që thotë, nëse nesër Komisioni Europian krijon mundësi për vendet anëtare, apo kur ne ecim me një shkallë shumë më të përparuar drejt familjes europiane, kjo lidhet edhe me kapacitetin e pushtetit vendor për të përfituar projekte, për të menaxhuar fondin. Janë gjithë ato para, janë gjithë ato mundësi. Pse, mos vallë për hir të ndasive politike e të llogarive, që asnjëherë nuk janë gdhendura në mur, se ato ndryshojnë, jeta politike ndryshon, numrat ndryshojnë; sot dikush mund të jetë i fuqishëm në një zonë, nesër mund të dalë një forcë tjetër. Ama ne nuk mund ta dëmtojmë popullatën në tërësi, e sidomos për të privuar nga këto mundësi ato territore që nesër do të synojnë nesër të qeverisin.

Prandaj, unë do të rekomandoja që me grupin e ekspertëve, nisur edhe nga eksperiencat e mëparshme, të ndërtojmë një metodologji, të publikojmë qëllimet, motivet, ajo çfarë synohet, kapacitetet që duhet të ketë pushteti vendor. Pra, të mos nisemi vetëm nga distancat. Pastaj çfarë distancash? Distanca me dhjetë njerëz? Të gjithë jemi njerëz elektorale. Unë kam bredhur në gjithë Shqipërinë me fushata elektorale, nga Veriu në Jug. Ku ka më njerëz në disa fshatra? Ne e dimë shumë mirë. Ajo që kompenson është teknologjia. Dëgjojmë këtu: pse nuk popullohen? Nuk popullohen më fshatrat. Edhe po të duam ne, nuk mund t'i kthejmë dot më. Edhe ata që kanë ikur nuk kanë më tendencë të kthehen në fshat, por do të shkojnë nëpër qytete, do t'u afrohen më tepër qendrave urbane. Janë disa shërbime, që dikur i ofronte komuna, por që tani s'ka më fare nevojë për komunë. Ka edhe shumë gjëra të tjera, si shërbime postare, shërbimet nëpërmjet internetit, ku shumë produkte ofrohen *online*. Tani ne nuk mund të bëhemi mohues të teknologjisë e të lehtësive që na ka krijuar teknologjia.

Prandaj, unë them që duhet të fokusohemi te metodologjia dhe *white paper*-i, që është baza e mirë për të filluar diskutimin. Pastaj le të dalim te numrat, që mund të jenë 90, mund të jenë 100, mund të jenë 50, mund të jenë 70. Kjo do të duket duke u bazuar në ato parime.

Këtë e kisha si sugjerim mirëkuptues. Nuk ia vlen të bëjmë tribunë politike këtu, e tha mirë Klosi, që po të heqim kamerat mbase biseda bëhet më teknike e më interesante. Ka disa parlamente që nuk mbajnë kamera fare nëpër komisione pikërisht për këto arsye. Sepse, kur vë kamerat, secili zë llogoren e tij politike dhe errëson logjikën racionale, e cila na çon drejt një përfundimi.

Faleminderit shumë!

Ju uroj suksese dhe shpresoj që edhe kjo mbledhje e parë të dalë me një produkt konsensual për të hapur rrugën.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Zoti Nallbati, fjala për ju.

Bledion Nallbati – Faleminderit!

Së pari, unë dua t'i uroj punë të mbarë këtij komisioni, që të dalë me një produkt sa më të mirë e në interes të qytetarëve. E që produkti të jetë në interes të qytetarëve, kjo varet nga mënyra se si ne e shikojmë pozicionin tonë këtu ku jemi ulur. Nëse kemi ardhur këtu duke e menduar veten tonë si shërbëtorë të qytetarëve, pa diskutim që do të kemi një produkt të mirë. Nëse e shikojmë veten si shërbëtorë të partisë e të pushtetit, pa diskutim që produkti do të jetë ai që ka qenë, ai i 2014-ës, e ndoshta edhe më i keq, sikundër duket tendenca.

Jam dakord me atë që thanë dy kolegët, se po të ishim pa kamera, jam i sigurt se, sikundër kemi bërë edhe plot diskutime me kolegë të mazhorancës, të gjithë janë të qartë se ajo që ndodhi në vitin 2014 ka dëmtuar interesin publik të qytetarëve, ka larguar shërbimin, ka krijuar shpopullim, ka krijuar varfëri dhe largim të vëmendjes apo mospasje të vëmendjes në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Dëgjova që u tha se po t'i pyesim qytetarët, ata do ta pranojnë se reforma ka qenë e suksesshme. Atëherë le të bëjmë një zgjidhje shumë të mirë ne, që të mos kemi probleme: të paraqesim dy propozime dhe ta bëjmë reformën me referendum, dhe le ta votojnë qytetarët. Ta shohim se si e duan qytetarët. Le t'ua lëmë në dorë qytetarëve, pse ta mbajmë ne? Ne nuk jemi më të mençur se të gjithë shqiptarët. A jemi në shërbim të interesit të qytetarëve? Biem dakord, nxjerrim dy produkte, atë që doni ju e atë që duam ne, dhe e kalojmë në referendum, meqë jemi në shërbim të interesit të qytetarëve dhe meqë qytetarët janë të kënaqur me reformën. Por unë jam i sigurt se qytetarët nuk janë të kënaqur. Unë kam qenë kryetar bashkie kur u zbatua ajo reformë, e cila krijoi pafundësisht shumë probleme. Nuk është thjesht çështje numrash, por çështje kompetencash, çështje financash, çështje e vëmendjes së qeverisë ndaj pushtetit vendor,

që gjithmonë është parë si sekondar. Në fakt, nëse ka një institucion që është i rëndësishëm për qytetarët, ajo është njësi vendore, bashkia. Qytetarin nuk e lidh absolutisht asgjë në jetën e tij të përditshme, në problematikat e tij të përditshme, me ministritë, me Kryeministrin, por e lidh me kryetarin e bashkisë. Që qytetari të jetë në qendër të vëmendjes, kryetari i njësisë vendore, bashki, komunë a çfarëdo emri t'i vëmë, ky njeriu që zgjidhet me votën e qytetarit duhet të jetë i prekshëm nga qytetari.

Në qoftë se ne ecim me këtë ide, që të bëjmë institucione sa më të mëdha, duke bashkuar territore e duke larguar të zgjedhurin nga qytetari, pa diskutim që vëmendja e të zgjedhurit nga qytetari do të jetë absolutisht shumë herë më e vogël nga sa është sot. Në qoftë se vëmendja e të zgjedhurit është më larg, patjetër që shërbimet janë shumë më të dobëta, gjë që e dimë mirë. Ne mund të flasim sa të duam, mund të bëjmë retorikë sa të duam, por ama realitetin e dimë që të gjithë. Në qoftë se kryetari i bashkisë, kryetari i njësisë vendore nuk është i prekshëm nga qytetari, që ai t'i trokasë dhe t'i qajë hallin, reforma është absolutisht dështuar.

Për sa i përket pjesës së kompetencave, pa diskutim që është e nevojshme të rishikohen, është e nevojshme që bashkitë të marrin kompetenca të reja, por të suportuara me logjistikën e duhur. Sepse u dhanë disa kompetenca në 2015-ën, por së pari gjysma e tyre ishin të dualizuara, si shërbimet në bujqësi, shërbimet në arsim; së dyti kishte përplasje institucionesh, por edhe hedhje e përgjegjësisë dhe e topit te njëri-tjetri. Bashkia thoshte se e ka qeveria, ndërsa qeveria thoshte se e ka bashkia. Kjo gjë nuk funksionon. Ju thoni që do të bëjmë një reformë, sepse do të shkojmë në Bashkimin Europian, do të shkojmë drejt Europës. Po cila është Europa? A nuk është Gjermania Europa? A nuk është Zvicra Europa? A nuk është Italia Europa? A nuk është Franca Europa? E pra, të gjitha këto kanë një mesatare shumë më të madhe të njësisë të qeverisjes vendore, dhe një numër mesatar shumë më të vogël të banorëve për njësi vendore. Ne do të shkojmë në Europë, po kur vjen puna këto lloj kalkulimesh e këto lloj reformash, nuk e di se ku e marrin shembullin. Sepse po jua them: merrni Gjermaninë, Francën, Italinë, Zvicrën, edhe Kroacinë, që përmendi Xhelali, e pastaj le të marrim shembullin e tyre. Por jo të themi: ne do të shkojmë tek ata, por me modelin tonë, me model kinez, apo ku di unë se çfarë. Kjo nuk funksionon. Unë nuk dua të bëj sot as debat politik e as të hyj në detaje teknike, sepse do të kemi kohë mjaftueshëm, por po jua përsëris edhe një herë: në qoftë se keni ardhur si shërbëtorë të qytetarëve, do të duhet të marrim ne konsensusin për të bërë një reformë në interes të tyre. Në qoftë se keni ardhur si shërbëtorë të partisë e të pushtetit, sikundër keni vepruar deri më sot me të gjitha reformat që keni bërë, e nëse doni mund t'ju përmend edhe reformën në drejtësi, reformën për gjykatat e prokuroritë, shkrirjen e tyre, shikoni edhe efektin e tyre se si

është. Sepse dolët e thatë se po bëni një mrekulli. Sot është bërë e pamundur për qytetarët që të ndjekin një proces gjyqësor. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me këtë.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Fjala për zotin Jahaj.

Klevis Jahaj – Faleminderit!

Edhe unë, meqë po e marr fjalën për herë të parë në këtë komision, dua t'u uroj suksese të gjithë kolegëve.

Realisht, mendoj se është një nga komisionet më të rëndësishme sa u përket shërbimeve që lidhen direkt me qytetarët. Kam përshtypjen se të gjithë themi këtu se s'duam të bëjmë politikë, por prapë nuk i shmangemi dot këtij procesi. Në njëfarë mënyre, rezultatet e 11 majit e dhanë përgjigjen se duhet të jenë me referendum këto vendimmarrje, përderisa qytetarët e kanë zgjedhur se kush duhet t'i drejtojë aktualisht.

Gjithsesi, është shumë e rëndësishme që ne, të gjithë së bashku, të ngremë këtu disa parime teknike, e më pas të kalojmë në zgjedhje politike. Besoj se analiza e reformës së parë territoriale do t'i shërbente shumë këtij komisioni dhe të gjithë anëtarëve të komisionit, se cilat kanë qenë ato rezultate që ju përmendët, qoftë në kuptimin e përmirësimeve, qoftë në kuptimin e rezultateve që nuk janë aq shumë optimiste. Nëse ne ngremë disa parime dhe një metodologji të caktuar, se si duhet të zhvillohet në vazhdimësi diskutimi për ndarjen territoriale nga ana e administrimit financiar, dhe ndarjen e kapaciteteve që duhet të kenë njësitë e reja të qeverisjes vendore, që të rrisin aftësitë e tyre për të thithur fonde të Bashkimit Europian, ndarja e këtyre dy koncepteve ekonomike dhe e aftësive të burimeve njerëzore, me atë të administrimit të territorit dhe të shërbimeve kundrejt qytetarëve, janë baza themelore për të realizuar një reformë të suksesshme territoriale në vazhdimësi.

Më pas, besoj se bashkëngjitur idesë politike se çfarë do të prodhojë kjo në rezultatet e tjera, qoftë të zgjedhjeve vendore, qoftë të zgjedhjeve që lidhen me qeverisjen, janë pjesë e një diskutimi më ndryshe, që besoj se u përkasin edhe komisioneve të tjera. Nuk besoj se reforma territoriale e 2014-ës ka prodhuar këtë rezultat që ne kemi aktualisht. Po ashtu, nuk besoj se ndikimi i ndarjeve territoriale do të sjellë ndryshime të tjera në votën e qytetarëve. Mendoj se është shumë e rëndësishme që në disa shembuj të mirë që kemi në disa sektorë të ndarjeve, apo të rajonalizimit që kemi bërë, duke përdorur parimet e ekonomisë së shkallës, administrimit më të mirë, ndarjes më të mirë të kompetencave për administrimin e zonave, ndarjes më të mirë të përgjegjësisë që duhet të kenë njësitë e qeverisjes vendore, të bashkive ose strukturave të

tjera që mund të jenë, si prefekti, qarku e të gjitha me radhë, mund të sjellin një menaxhim më të mirë të financave publike, qoftë të administrimit të territorit, qoftë edhe të administrimit të burimeve njerëzore, që besoj se përbën edhe çelësin bazë të suksesit që do të na afrojë me shumë me standardet e Bashkimit Europian. Unë do të doja t'u propozoja të dy bashkëkryetarëve, që përtej dëshirës që kemi për të shprehur opinionet tona për qasjet politike, po edhe për ato teknike dhe eksperiencat që mbartim secili në administrimin që kemi pasur më përpara, qoftë edhe angazhimin tonë me qytetarët sa i takon votëbesimit që kemi marrë, është e rëndësishme të vazhdojmë me agjendën e caktuar, të përcaktojmë modalitetet ku duhet të bazojmë punën e këtij komisioni, të përcaktojmë ekspertët që do t'i shërbejnë këtij komisioni për të sjellë rezultate qoftë për analizën e reformës së vitit 2014, qoftë edhe se ku duhet ta bazojë punën ky komision në vazhdimësi për të marrë vendime.

Unë besoj se fryma e ngritur jashtë ndasive politike, por e bazuar vetëm te fokusi për shërbimin ndaj qytetarëve, e këtu përgëzoj edhe kolegun Mziu, që ishte konkret në propozimet e tij, duke marrë shembuj nga mënyra e organizimit edhe të vendeve tjera të rajonit ose të Bashkimit Europian, mendoj se do të na drejtojë të gjithëve në punën tonë, duke qenë se edhe koha për vendimmarrje dhe koha për aktivitetin e këtij komisioni nuk është në favorin e të gjithëve.

Shumë faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit, zoti Jahaj!

Fjalën e ka kërkuar zoti Haxhinasto.

Më pas e ka radhën zoti Likaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Haxhinasto e ka kërkuar fjalën pak më përpara.

Edmond Haxhinasto – Unë si tolerant që jam, mund t'ia lë radhën me kënaqësi.

Arbjan Mazniku – Në rregull.

Zoti Likaj.

Ramadan Likaj – Vazhdo, vazhdo, pa problem.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit!

Në fakt, do të doja t'i uroja edhe zotit Boçi të njëjtën gjë që ju urova juve herën e kaluar, zoti bashkëkryetar, që të keni sukses në këtë punë.

Pa diskutim që është një objektiv i përbashkët që ky komision të jetë i suksesshëm, e që ato që do të propozojë të jenë të qëndrueshme, por edhe një ndryshim cilësor, i cili të na

ndihmojë e të na lehtësojë në arritjen e atyre objektivave që kemi në kuadër të integritetit evropian.

Besoj se pika e referencës të 11 maji është diçka e gabuar, zoti bashkëkryetar, sepse është, si të thuash, recetë për të paragjykuar e për të denigruar qëllimin shumë të lartë të këtij komisioni për të realizuar një reformë të qëndrueshme, po edhe për faktin se dihet shumë mirë se çfarë pasojash e çfarë mënyrash u përdorën, duke qenë se dëgjova disa kolegë, të cilët iu referuan 11 majit dhe rezultatit zgjedhor, dhe mendoj se kjo është sfida më e madhe që kemi. Ne duhet të dalim përtej interesit politik, nëse duam qëndrueshmërinë e reformës që jemi duke realizuar. Sepse defektet e mëdha, që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve njerëzore të administratës vendore në funksion të zgjedhjeve, të cilat u paraqitën shumë qartë edhe në raportet e OSBE/ODIHR-it, janë treguesi se si nuk duhet bërë reforma, që nuk duhet lënë hapësirë që ato defekte të përsëriten prapë dhe të krijojnë atë problematikë të madhe, të jashtëzakonshme, që ekziston edhe sot.

Prandaj, unë mendoj se nëse arrijmë të hidhemi përtej atij interesi politik që lidhet me shpërdorimin e burimeve njerëzore të pushtetit vendor, besoj se kemi arritur diçka shumë të madhe. Kjo duhet të jetë një ndër pikat e konsensusit të përgjithshëm në të dyja krahët e kësaj tryeze.

E theksova edhe në mbledhjen e kaluar faktin se është e nevojshme të bëjmë një analizë në lidhje me çfarë ka funksionuar e çfarë nuk ka funksionuar nga reforma e kaluar. Kjo do të jetë pika e nisjes, sepse edhe për këtë çështje ka këndvështrime të ndryshme. Unë po u referohem disa prej reformave që u realizuan pas reformës territoriale, konkretisht reformës së ujit, reformës së trajtimit të mbetjeve, transportit ndërqytetës, që fatkeqësisht janë dështime. Kjo tregon se realisht, pushteti vendor nuk kishte kapacitetet për t'i gëlltitur këto reforma e për të realizuar cilësinë e shërbimeve që priteshin prej tyre. Pra, faktori njerëzor është absolutisht faktor kyç në realizimin e gjithçkaje që ne parashikojmë të realizojmë me reformën e re.

Gjithashtu, dua të them se në trajtimin e kësaj reforme duhet të shikojmë problematikën që na vjen tani, gjatë trajtimit të buxhetit, nga pushteti vendor, nga përfaqësuesit e saj. Duhet ta kemi parasysh. Referenca prej 1% e buxhetit nuk është e mjaftueshme. Kam përshtypjen se me pavarësinë që pushteti vendor duhet të ketë, buxheti i tij duhet të shkojë proporcionalisht me rritjen ekonomike, sepse aty janë qytetarët, aty është cilësia e shërbimeve që marrin qytetarët. Kësisoj, edhe në lidhje me këtë duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

Dëgjova në lidhje me bashki që luftojnë, kanë rritje të buxheteve të tyre, por që nuk arrijnë dot të paguajnë borxhet. Dëgjova se ka bashki, të cilat nuk marrin rentën minerare, që

u takon ta marrin. Pra, këto problematika që dalin nga diskutimi i buxhetit, ne duhet t'i adresojmë dhe t'i sanksionojmë me zgjidhje shumë të qarta për të ardhmen.

Në fund fare, zoti bashkëkryetar, meqenëse sot është diskutimi i agjendës, mendoj se ne duhet të jemi të qartë në agjendë edhe në lidhje me pritshmërinë e asaj që duhet të bëjmë ne si komision. Unë e kuptoj se aty u referohemi ekspertëve, por puna e ekspertëve është *vis a vis* me punën e komisionit. Duhet ta qartësojmë këtë gjë, me qëllim që ekspertët të na japin patjetër metodologjinë ose metodën e tyre, por vendimmarrja sigurisht që do t'i përkasë këtij komisioni, gjë për të cilën duhet të jemi shumë të qartë edhe në përgatitjen e agjendës.

U përpoqa të shikoja konkretisht se çfarë do të mund të bëjë komisioni, çfarë pritshmëri ka, çfarë funksionesh do të ketë në përgatitjen e dokumentit bazë, dhe mendoj se ka vend për detajime të mëtejshme.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Zoti Boçi, a do t'ia jepni ju fjalën zotit Malaj, sipas rregullit?

Luçiano Boçi – Po.

Faleminderit, zoti Haxhinasto!

Fjala për ju, zoti Malaj.

Agron Malaj – Përshëndetje të gjithëve!

I uroj suksese komisionit!

Reforma administrative e vitit 2015 ka qenë një ndër reformat më të suksesshme, por që ka nevojë të thellohet akoma më shumë, e për këtë flasin faktet, përtej ngjyrave politike. Po të vëmë re të shifrat e statistikave e fundit, kapacitetet e bashkisë janë rritur me 80%, me përthithjen e investimeve të huaja. Të ardhurat e bashkive janë rritur me 166%. Investimi për frymë është rritur me 78%. Kemi edhe shumë shifra të tjera, por nuk dua të ndalem këtu më gjatë. Mund të përmend faktin se reduktimi i detyrimeve të prapambetura është ulur me 40%, sikundër e tha edhe kolegu parafolës. Pra, këto janë fakte që flasin me shifra. Gjithsesi, kuptohet se kjo reformë duhet thelluar akoma më shumë, sepse kemi një ndasi midis bashkive të mëdha dhe bashkive të vogla.

Po të marrim si shembull Tiranën dhe gjashtë bashki më të mëdha, kanë afërsisht 75% të të ardhurave në rang vendi, në rang kombëtar. Ndërkohë, 44 bashki të tjera me më pak se 50 mijë banorë kanë të ardhura rreth 15%. Kësisoj, unë mendoj se kjo reformë duhet thelluar akoma më shumë. Duhet ta bëjmë akoma më të hapur, akoma më të gjerë, sepse po të bazohemi te këto statistika, vëmë re se reforma administrative e vitit 2015 ka pasur një sukses shumë të

madh. Po të kthehemi para 2015-ës, me 380 komuna apo bashki, në të vërtetë nuk ishin në gjendje të paguanin as pagat e punonjësve, jo më të kryenin shërbime në komunitet. Shërbimet nuk janë fjalë, takime e kontakte, por janë investime, janë shërbime konkrete ndaj banorëve, ndaj qytetarëve të zonave.

Pra, na duhet ta rishikojmë dhe të bëjmë një analizë të thellë me shifra e me statistika, që të mund të dalim në konkluzionin se kjo reformë duhet thelluar akoma më shumë.

Shumë faleminderit!

Arban Mazniku – Faleminderit!

Zoti Likaj.

Ramadan Likaj – Faleminderit!

Në radhë të parë i uroj suksese këtij komisioni! Shpresoj e besoj fort që ne të gjithë anëtarët e këtij komisioni të dalim përtej vetes, pritej forcës politike që përfaqësojmë, nëse realisht duam t'u ofrojmë qytetarëve një reformë që të jetë sa më afër shërbimit për qytetarët.

Unë mendoj se si ish-kryetar bashkie për dy mandate, kam pasur fatin të jap edhe mendimin tim në reformën që u vu në zbatim në vitin 2015. Sigurisht, nuk dua të hyj në statistika e në gjëra teknike, sepse do të merremi me këtë në kohën e përshtatshme, por sipas gjykimit tim dhe sipas gjykimit real që reflektohet te shërbimet ndaj qytetarëve, ajo reformë nuk solli pritshmërinë e duhur. Sot kryetari i bashkisë ka shumë më pak kontakte me qytetarin. Delegimi i kompetencave u shkon administratorëve, në një kohë kur ne duhet ta themi se këtu ka kryetarë bashkish që e kanë lënë tani postin. Nuk them se janë të papërgjegjshëm, por në qoftë se një njeri, cilido kryetar, nuk është i emëruar, sigurisht që nuk e merr dot shërbimin siç duhet. Përgjegjësia shkon gjithmonë te i zgjedhuri. Ky është një fakt i pamohueshëm.

Diskutohet se në këtë reformë ka edhe bashki që nuk e kanë mbajtur dot veten, ndaj kanë detyrime, kanë borxhe. Sigurisht që kanë borxhe, për sa kohë që pjesa më e madhe e të ardhurave që kanë sot bashkitë i kanë kaluar pushtetit qendror. Por në qoftë se në një moment të caktuar flasim për borxhe te qeveria, kush e merr në gjykim qeverinë që ka gjithë ato borxhe? Pra, unë mendoj se i hyjmë kësaj çështjeje dhe i shohim gjërat hap pas hapi, mund të themi se kjo reformë solli braktisjen e një pjese të madhe të fshatrave. Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësive për të mbijetuar në ato zona. Unë nuk dua t'i kthehem asaj çështjeje e të them: jo ishin 280 bashki, apo 300 komuna, iku ajo kohë, por mund të them se shërbimi ndaj qytetarit ka qenë shumë-shumë më efikas. Kërkesa ka qenë shumë-shumë më efikase. Këto mund të shihen, sepse janë me fakte, dhe ne duhet ta pranojmë këtë, duke dalë përtej vetes, zoti bashkëkryetar.

Unë mendoj se nëse dy grupet tona e kanë dëshirën, ose më saktë nëse ju e keni dëshirën, pasi realisht ne e kemi dëshirën, për të ofruar një produkt që i shërben qytetarit, absolutisht që ne jemi të gatshëm. Nëse ju i keni gjërat të parapërcaktuara, pa i marrë në konsideratë ato që u thanë nga kolegët, atëherë mund të themi se kjo çështje është e dështuar qysh në krye të herës. Sigurisht, interesi është i të gjithëve ne këtu për t'u mundësuar sa më shumë shërbime qytetarëve. Për këtë po flasim, për këtë po diskutojmë.

U trajtua edhe një pikë tjetër nga kolegët, që qytetari e merr pjesën *online* më të madhe të shërbimeve. Po investimet si i merr qytetari? *Online*? Jo. Në qoftë se unë futem sot thjesht për aparencë tek investimet, kuptojmë se komunat kanë pasur rol shumë të fuqishëm, të jashtëzakonshëm. Ka pasur një sukses të jashtëzakonshëm në atë kohë. Ka pasur edhe një konkurrencë të jashtëzakonshme mes bashkive e komunave sa u përket investimeve. Të gjithë banorët qëndronin në fshatrat e tyre, ndërkohë që tani fshatrat janë braktisur totalisht. Nëse marrim si shembull këto dhjetë vitet e fundit, duke pasur parasysh për zonat ku unë jam, çka se në fakt e njëjta gjë është kudo në Shqipëri, disa fshatra që dikur kanë pasur 1000-1500 banorë, sot nuk kanë as nga 100 banorë. Le pastaj të diskutojmë për gjëra të tjera, si shkolla të mbyllura, njerëz të larguar.

Unë nuk dua të bëj politikë sot, por duke pasur edhe dy bashkëkryetarë, ne kemi bindjen e plotë se do të biem dakord, e në fund të ditës e në fund të kësaj pune të mund të nxjerrim një produkt të përbashkët, një produkt që realisht të jetë në shërbim të qytetarëve. Shpresoj se ne do ta ofrojmë kontributin tonë maksimal, që qytetarët të mund të kenë një ndarje të re administrative e me shërbime sa më afër interesave të qytetarëve.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Zonja Bylykbashi, fjala për ju.

Aulona Bylykbashi – Shumë faleminderit!

Të nderuar bashkëkryetarë,

Të nderuar kolegë,

Suksese në punën e këtij komisioni, i cili besoj se do të sjellë një produkt e një rezultat të mirë, ashtu siç e kërkon koha.

Personalisht, unë mendoj se kur ndërmarrim një reformë, pyetja e parë që të gjithë ne i bëjmë vetes, është: ku duam të arrijmë, dhe cili është rezultati që duam të arrijmë? Besoj se në lidhje me rezultatin që synojmë, biem të gjithë dakord. Ne duam të arrijmë në një organizim,

në të cilin njësitë e qeverisjes vendore, qofshin në rangun e bashkive, qarqeve apo prefekturave të kenë funksione dhe rol që të mund të miradministrojnë, që çojnë investime te qytetarët, që përmirësojnë shërbimet, e që sjellin një rritje të cilësisë së jetës së qytetarëve, të cilëve u shërbejnë.

Nisur nga kjo, dua të them se reforma e vitit 2014 ka dhënë një rezultat të dukshëm në përmirësimin e shërbimeve dhe investimeve në të gjitha zonat. Fatmirësisht, sot ne kemi një sistem të matjes së performancës së njësitë të qeverisjes vendore, e cila bazohet në një sërë treguesish. Nëse shikojmë rezultatet e kësaj performace do të kuptojmë se cilësia e jetesës është rritur ndjeshëm qoftë kjo në ofrimin e shërbimeve, qoftë në realizimin e investimeve. Sigurisht, lëvizjet demografike përbëjnë një fenomen që nuk e shmangim dot ne, por nuk e shmang dot asnjë popullsi në çdo vend të botës, sepse bazohet në arsye e kritere të ndryshme, e jo ashtu siç u fol deri tani, që vjen si rezultat i reformës së vitit 2014. Përkundrazi, sot ato që kanë qenë komuna, nga rezultatet të faktuara tregojnë se marrin në mënyrë të përmirësuar shërbimet e menaxhimit të mbetjeve, dhe kanë marrë në masë të konsiderueshme më shumë investime.

Këtë çështje e preka sa për të thënë se ndoshta analiza e kësaj reforme do të na bëjë ne të nxjerrim arsyet, elementet që e kanë çuar një pjesë të madhe të bashkive që vjen nga kjo reformë, në një miradministrim të fondeve, në një rritje të performancës, në një mbledhje më të madhe të të ardhurave. Nga krahu tjetër, sigurisht, kemi edhe njësi të qeverisjes vendore që nuk kanë performuar në të njëjtën masë si bashkitë më të mëdha.

Kështu, një analizë e thelluar e reformës së vitit 2014 dhe e rezultateve që ka dhënë, do të na bëjë të kuptojmë se çfarë ka përmirësuar dhe në çfarë elementesh kanë ceduar njësitë e tjera për të shërbyer pastaj si bazë për përdorimin e këtyre elementeve në punën tonë gjatë këtij komisioni.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Zoti Luku dhe më pas zonja Koçeku, për ta mbyllur.

Artan Luku – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua t'i uroj punë të mbarë komisionit!

Nuk dua ta nis fjalën time duke folur për sukseset e reformës së viteve 2014-2015, sepse ne gjithmonë flasim për sukseset, duke harruar faktorin “k” (kohë). Faktori “k” është zhvillimi ekonomik, të cilin disa prej nesh e trumbetojnë me të madhe, por faktori “k” ka të bëjë edhe me zhvillimin ekonomik në çdo cep të botës, do të thosha, dhe jo vetëm në Shqipëri, si efekt i reformës territoriale.

Mendoj se, nëse ky komision dëshiron të bëjë një reformë siç duhet (në fakt, këtu bashkohem me njërin nga kolegët, i cili tha se duhet të përcaktojë metodologjinë e vet), nuk ka nevojë të bëjmë ndonjë shpikje të jashtëzakonshme, por duhet të caktojmë një metodologji nisur nga eksperiencia e vendeve të BE-së.

Për mua është e parëndësishme nëse janë 60, 100 apo 120 njësi administrative, më e rëndësishmja është që ne të kemi një reformë të bazuar në metodologji që bën ndarjen e drejtë të zonave, në një metodologji të bazuar në marrëdhëniet tregtare dhe historike që kanë pasur zonat ndërmjet njëra-tjetrës, si dhe në marrëdhëniet infrastrukturore që kanë.

Metodologjia jonë duhet të bëjë identifikimin e shërbimeve, identifikimin financiar të zonave, duhet të bëjë teste... Po lexoja për ndarjen territoriale në vendet e Bashkimit Europian dhe, po ta shohësh (është e çuditshme), vendet e Bashkimit Europian e kanë bërë ndarjen territoriale pothuajse 30-40 vjet më parë, ndërkohë që nuk e di për të satën herë e bën Shqipëria.

Nëse ne nuk e bëjmë reformën territoriale bazuar në këto metoda eksperte, atëherë mendoj se nuk do të jetë reforma e fundit, por do të kemi përsëri pas një periudhe jo fort të largët dhe do të jetë reformë politike, jo e bërë sipas nevojave që kanë qytetarët apo e bazuar në zhvillimin që duhet të marrin rajone të ndryshme të Shqipërisë. Ndaj sugjeroj që ky komision, në momente të veçanta të vetat, duhet të zbresë nga niveli politik në nivelin e ekspertëve, duke u bërë pjesë e grupit të ekspertëve dhe duke u përfshirë seriozisht në këtë reformë.

Uroj suksese dhe që reforma të shihet me të vërtetë jashtë barrierave politike, jashtë ndasive politike, dhe të bëjmë diçka që të jetë në të mirë të qytetarëve.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Faleminderit, zoti Luku!

Fjalën e ka zonja Koçeku.

Marjana Koçeku – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Atëherë, siç shumë prej jush vijnë nga eksperiencia në pushtetin vendor, unë vij nga terreni dhe, realisht, dua ta shoh me syrin e banorëve dhe të qytetarëve, veçanërisht këtë lloj reforme, dhe besoj se, me qëllimin që ajo të jetë sa më efektive në terren dhe për komunitetet për të cilat ne punojmë dhe i përfaqësojmë sot këtu, duhet parë pikërisht me syrin e tyre dhe kryesisht të zonave të thella dhe qyteteve më pak të vogla, dhe këtu duke e menduar veten jashtë Tiranës, sepse në kryeqytetin tonë mundësitë janë të shumta, por jo të gjitha zonat e Shqipërisë mund të ofrojnë të njëjtat shërbime dhe facilitete si këto.

Unë besoj shumë se duhet një zhvillim më i thellë horizontal, duke ua dhënë të gjithëve mundësitë, si atyre që jetojnë në zonat e thella të Pukës, në zonat e Veriut, ashtu edhe në ato të Jugut. Do të jetë sfidë e madhe, pasi besoj se një vëmendje të veçantë në këtë reformë duhet t'i dedikohet, siç u përmend edhe më përpara, administratës, meritokracisë, pa dyshim, të pushtetit vendor, por edhe aftësimin profesional të mëtejshëm të tyre, aq më tepër duke marrë parasysh edhe procesin në të cilin jemi, në prag të anëtarësimit.

Pa dyshim, kjo reformë duhet të prekë nga afër jetët e shumë njerëzve dhe lidhet drejtpërdrejt me komunitetin dhe me terrenin, ndaj edhe duhet një bashkëpunim sa më i thellë dhe profesional midis të dyja palëve, që besoj se nuk do të na mungojnë.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Luçiano Boçi – Mundem?

Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Meqenëse nuk ka diskutantë të tjerë, do të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

Si pikë të parë kemi shqyrtimin e projektvendimit për caktimin e sekretarit të komisionit.

Meqenëse ende nuk janë përcaktuar grupet e ekspertëve të të dyja niveleve, propozoj që këtë çështje ta zhvendosim në mbledhjen e ardhshme, ku mund të diskutojmë dhe të dalim me konsensus.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Shprehem dakord që ta diskutojmë në mbledhjen e radhës, pasi është një çështje për të cilën nuk kemi emergjencë për të marrë një vendim, bën edhe sens nga ana organizative, dhe ta shtyjmë në mbledhjen e radhës. Ndërkohë, për dy pikat e tjera do të doja të merrja pak minuta.

Së pari, për të diskutuar për draftkalendarin e punës, në mënyrë që të jemi të gjithë në një linjëzim kohe, për të kuptuar cilat janë pikat kryesore ose, të themi, stacionet kryesore të punës së komisionit, por edhe detyrat që ndoshta duhet të kemi në proces. Në thelb, komisioni do të duhet të dalë eventualisht me tri dokumente.

Tri ligje të rëndësishme që preken nga puna e komisionit janë: ligji nr. 139, që cakton në thelb funksionimin e pushtetit vendor, ligji për financimin e pushtetit vendor (kolona e dytë), pra mënyra e mekanizmit të financimit, dhe ligji për ndarjen territoriale (kolona e tretë), dhe këto janë tri produktet kryesore.

Tani, njëri prej këtyre produkteve ka një afat shumë specifik kohor. Duke qenë se, sipas praktikave më të mira të autoriteteve vendore, nuk është e udhës që një vit para zgjedhjeve të ketë ndryshime në territor, do të thotë se ne kemi një afat, që është periudha qershor-korrik e vitit që vjen, për të miratuar ndryshimin e hartës së territorit. Ndërkohë, për ligjin e pushtetit vendor, pra të kompetencave dhe të financave, mund të kemi pak më shumë kohë, pasi në çdo rast këto do të hyjnë në funksion pas vitit 2027. Ligji i hartës duhet të mbyllet brenda korrikut të vitit që vjen. Duke ecur mbrapsht nga kjo agjendë, kemi punuar për një agjendë me disa pika kryesore, ku hapi i parë i radhës është që në janar të vitit 2026, pra për një muaj, të nxjerrim dokumentin e parë analitik, që e kemi quajtur Dokumenti i Gjelbër ose *Green Paper*, i cili është një dokument që bën një analizë të reformës së vitit 2014 dhe sfidave kryesore që kemi sot. Është një dokument për diskutim publik për ato tema për të cilat do të duhet të bëjmë një debat, qoftë me ekspertët, qoftë me kryetarët e bashkive, qoftë me të zgjedhurit vendorë, qofshin këto kryetarë bashkish ose anëtarë këshillash bashkiakë, duke caktuar në të temat dhe pyetjet kryesore për të cilat duhet të flasim me njerëzit, qoftë për financat, për kompetencat, qoftë edhe për territorin, dhe një dokument udhërrëfyes për mënyrën si e bëjmë diskutimin publik.

Menjëherë pas kësaj, gjatë muajve janar-shkurt, për 5-6 javë, si komision, të marrim një kohë për konsultime publike në të gjithë territorin. Unë propozoj që ne të krijojmë skuadra me dy deputetë, plus ekspertëve, një nga mazhoranca dhe një nga opozita, dhe të marrim kohën që të shkojmë në territor, në të gjithë Shqipërinë, për të bërë një bisedë me të gjithë kryetarët e bashkive dhe të gjithë këshilltarët bashkiakë, sipas një agjende të dakordësuar mes palëve, por të shpenzojmë gjysmën e dytë të janarit dhe të gjithë shkurtin për të pasur mundësinë për të bërë diskutime në terren fizikisht me njerëzit.

Bazuar në këtë diskutim, por edhe te puna e ekspertëve, stacioni i dytë i madh është muaji mars i vitit 2026, gjatë të cilit duhet të synojmë të prodhojmë dokumentin e dytë të politikave, që është Dokumenti i Bardhë ose *White Paper*-i, ku janë të shkruara qartë të gjitha zgjidhjet e propozuara nga komisioni. Nuk jemi ende tek elementi legjislativ, por kemi dhënë kolonat në këtë dokument, të zgjidhjeve që mendojmë se duhet të kemi, qoftë kjo për kompetencat e bashkive, qoftë për financat, qoftë për territorin. Dokumenti i Bardhë është një dokument orientues politik, me zgjidhje konkrete. Edhe për këtë dokument marrim pastaj kohë gjatë muajve mars dhe prill për të bërë diskutime publike rreth tij, por në këtë rast, përveç diskutimeve në terren, do të kemi më shumë diskutime të bëra me ekspertë këtu, në komision, gjatë muajve prill-maj, në mënyrë që të shkojmë në fazën tjetër, që ndodh gjatë muajit maj 2026, ku fillojmë të hedhim strukturën e paketave ligjore dhe të kemi dokumentet e para ligjore

(dhe ky është stacioni i tretë, me përgatitjen e paketave ligjore nga ana e komisionit), në mënyrë që më pas të kalojmë në procesin legjislativ të miratimit të këtyre paketave, në proceset respektive parlamentare, në komisionet e tjera, në institucionet e tjera që duhet të japin më pas *feedback* të mirëfilltë, të drejtpërdrejtë, të dokumenti ligjor, dhe t'i fusim në proceset standarde të miratimit gjatë muajve qershor-korrik. Ky është një plan i përgjithshëm pune, me kolona kryesore. Nëse biem dakord për këto kolona, më pas do të marrim kohën për të bërë paketa të mirëfillta planesh për hapat e ndërmjetëm dhe punën e ndërmjetme, lidhur kjo edhe me pikën tjetër, që është çështja e grupit të ekspertëve dhe punës së tyre pranë komisionit, si dhe agjenda e dëgjësive dhe e diskutimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Boçi, pastaj zonja Tabaku.

Luçiano Boçi – Kam dy shqetësime.

Në raport me agjendën, përcaktuam që një nga ndryshimet kryesore është krijimi i kontakteve me qytetarët, sepse ata janë më të interesuarit, krahas takimeve me drejtuesit e bashkive për të dhënë mendimet e tyre për reformën. E kam në aspektin e shumësisë së takimeve, nëse do të mundemi vërtet ta marrim opinionin bruto të qytetarëve, sepse koha është e kufizuar, takimet në numër ndoshta janë të kufizuara... A mos duhet të gjejmë një mënyrë tjetër, modalitet, që vërtet opinionin e tyre të vijë pranë komisionit tonë dhe të jetë një opinion i pastër, pa ndikimet e veta politike, se kjo është kryesorja? Nëse ne bëjmë formalitete, vetëm takime me anëtarë të këshillave bashkiakë, me kryetarë bashkish, atëherë ne nuk kemi marrë një opinion real, konkret. Por mund t'i elaborojmë përgjatë kohës kur mund t'i realizojmë, ndoshta duke përdorur edhe sondazhe. Nuk e di, por mund t'i diskutojmë bashkërisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për pikën tjetër, në fakt, ju e dhatë edhe një shpjegim, por jo shumë të qartë.

Në pikën 11 thuhet: "Propozimi final dërgohet për mendim tek institucionet qeveritare." Për ta futur në hullinë ligjore të formatimit apo për të marrë dakordësinë, aprovimin dhe mosaprovimin e tyre? Se, në qoftë se ne bëjmë këtë punë dhe dikush nga qeveria na marrka në provim për këtë... duhet ta qartësojmë në mënyrë taksative, se do ta votojmë sot. Unë, që ta votoj, e dua shumë të qartë: dokumenti që ne do të prodhojmë, është imponues për qeverinë apo është qeveria që do të vendosë në fund fare; këtë dokument unë e konsideroj dhe jam i gatshëm që pas miratimit ta zbatoj, apo nuk më pëlqen dokumenti, vazhdojmë këtu ku jemi dhe e gjithë puna jonë shkërmoqet dhe rrëzohet? Pra këtu, para se ta hedhim në votë, të jemi shumë të qartë, se vendimet e këtij komisioni janë të detyrueshme për zbatim nga ekzekutivi. Ai mund

të bëjë retushimin ligjor të formatit që e mendon si të pranueshëm për debatet e mëtejshme në Parlament dhe të kemi një konkludim të saktë.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Atëherë, kam dy komente.

Së pari, jam shumë dakord që eventualisht te mjetet e punës sonë ne duhet të shohim opsionin që të kemi më shumë sesa një, pra disa sondazhe të bëra në mënyrë profesionale. Kemi shumë hapa këtu, që nuk i kemi. Në planin e punës janë vendosur vetëm pikat kryesore, por një ndër gjërat për të cilat duhet të biem dakord bashkërisht është që ne ta çojmë që sot kërkesën, veçanërisht për Kongresin e Autoriteteve Vendore, por edhe për të gjithë partnerët ndërkombëtarë, për organizatat që kanë tashmë një eksperiencë të gjatë pune këtu, për të na asistuar në këtë proces, qoftë me ekspertizë, qoftë me mjete të tjera. Dhe, pa dyshim, në këtë koncept ne duhet të shohim mundësinë që te ky lloj partneriteti të kemi edhe organizimin ose zbatimin e një serë sondazhesh për çështje të ndryshme apo nënkategori të ndryshme, për ta kuptuar më shumë opinionin e njerëzve, për ta futur atë në proces. Kështu që për këtë çështje jam plotësisht dakord.

Për sa i përket pjesës së dytë, kam përshtypjen se një pjesë të madhe të pyetjes suaj e kanë zgjidhur në parim ligji dhe Kushtetuta, që, pa dyshim, vendimet e Parlamentit janë detyruese për ekzekutivin. Por teksa ne do të marrim kohën, me të drejtë, për të marrë *feedback*-un nga bashkitë, shoqëria civile, universitetet, pa dyshim që, përveçse do ta kemi bashkudhëtar ekzekutivin në proces, ne do të bashkëpunojmë ngushtësisht me të, sipas tri kolonave të punës, në procesin e hartimit të akteve, sepse duhet të na vijë një *feedback* dhe ekspertizë nga ekzekutivi, por, eventualisht, kur produkti të jetë mbaruar, marrja e opinionit është proces standard në proceset legjislative që bëhen nga Parlamenti. Pra, sa herë ka një proces legjislativ, që bëhet nga Parlamenti, dërgohet për një opinion në qeveri, dhe Parlamenti prapë, në të gjitha rastet, ka vendimmarrjen sovrane. Marrja e opinionit është proces standard në të gjitha proceset legjislative...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pothuajse gjithmonë. Dhe marrja e opinionit nuk na prish ndonjë punë, përkundrazi, na ndihmon.

Fjalën e ka kërkuar zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Dua të ndalem te dy elemente.

Të parin ju e sqaruat dhe besoj se të dy bashkëkryetarët duhet t'u nisin një kërkesë të gjitha organizatave që po punojnë aktualisht me pushtetin lokal, dhe nuk janë pak.

E dyta, Parlamenti nuk është në punë gjatë gjithë muajit janar, pasi ne fillojmë të hënën e tretë të janarit, ndaj janari mund të përdoret ndoshta për të prodhuar *Green Paper*-in dhe ta lëvizim pak raundin e konsultimeve, të dëgjesave publike, sepse i kemi në janar-shkurt 2026, dhe do ta kemi të vështirë të dalim në terren, ndërkohë që Parlamenti nuk është në punë, të paktën nga eksperiencia e komisioneve të tjera, kur nuk janë në sesion.

Së treti, unë besoj se ne biem të gjithë dakord këtu se nuk mund të themi cilat janë arritjet e reformës së parë administrativo-territoriale, por të paktën të themi gjetjet nga reforma e parë, nëse do të kemi një kalendar të përbashkët, sepse, në qoftë se këtu na thuhet që kemi arritje të mëdha, atëherë unë besoj se kjo është një pikë që na ndan të dyja palët. Të themi: gjetjet, zbatimi i reformës administrativo-territoriale, faza e parë; parimet e së dytës, sepse nisemi me një prezumim të gabuar, të paktën për palën tonë.

Së katërti, me sa kuptoj, do të ketë dy faza dëgjesash.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Po, faza e parë e dëgjesave do të jetë në terren, për të mbledhur problematikat, ndërsa faza e dytë pasi të kemi një draft. Ndoshta këtu për të akomoduar...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Po, dhe pastaj faza e tretë.

Tani, për të akomoduar shqetësimin që ka zoti Boçi, që është edhe shqetësim i përbashkët, mendoj se institucionet e qeverisë, veçanërisht Ministrinë e Financave, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Shoqatën e Bashkive duhet t'i presim këtu, kur të kemi dëgjesat dhe t'i akomodojmë shqetësimet e tyre.

Produkti final duhet të dalë nga ky komision. Kështu ka qenë edhe për produktin final të vitit 2015, pavarësisht se vendimi ka qenë i njëanshëm, për të hequr edhe meraket e të gjithëve ne që jemi këtu, se unë nuk e diskutoj që ju jeni sovran, domethënë, e keni vërtetuar këtë me kohë, por që të heqim të gjitha meraket e të gjithëve se ky do të jetë një produkt, në qoftë se të dyja palët bien dakord... Mendoj se mund t'i akomodojmë diku të shqyrtimi i rekomandimeve dhe miratimi i draftpropozimit edhe institucionet qeveritare, një listë institucionesh, që mund të vijjnë në këtë komision dhe të sjellin shqetësimet, sugjerimet dhe kërkesat e tyre.

Zoti Gjijnuri ndoshta ka më shumë eksperiencë, por komisionet e tilla të posaçme besoj se kanë një procedurë tjetër legislative. Produkti ynë nuk ka nevojë të kalojë procedurën normale të kalimit të ligjeve në Parlament, madje secili prej nesh këtu besoj se do të ishte më komod në qoftë se produkti do të dilte që këtu dhe jo nga zyrat e qeverisë.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Atëherë, e përsëris, pa dyshim që produkti do të dalë nga këtu.

Arsyeja pse unë ende mendoj se është shumë e dobishme që produktin në fund ta çojmë për një proces, siç do të bëhet procesi i tretë konsultativ i dokumentit ligjor në vetvete dhe siç bëhet gjithmonë, pra ta çojmë për një diskutim të qenësishëm tek ekzekutivi, është sepse ky ligj rregullon një seri fushash, rregullon çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet sociale, çështjet që kanë të bëjnë me utilitetet, me shërbimet e ujit apo të energjisë, çështjet që kanë të bëjnë me arsimin, me punësimin, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me financat, si rregullon edhe elemente ndërveprimi të ngushta midis qeverisë dhe pushtetit vendor. Ndaj, pa dyshim, ne do ta kemi ekzekutivin në të gjithë hapat, por edhe te hapi i fundit: si është shkruar akti, si është shkruar neni 17, pika 2, për mënyrën se si ofrohet shërbimi social, institucioni përkatës thotë: dëgjo, kjo fjala kështu, po të ishte më mirë kështu, ndoshta e arrin më mirë objektivin. Nuk kemi asnjë humbje të sovranitetit të institucionit, nëse i pyesim të gjitha palët. Dakord? Por kjo është çështje paraprake, nuk besoj se është shqetësim ai.

Nga ana tjetër, për çështjen e parë, jam dakord me ju se dy-tri javët e para të janarit janë... Prandaj edhe ne kemi thënë “janar-shkurt”, ku deri në janar të përdorim kohën edhe nga ekspertët për të prodhuar dokumentin.

Në leximin tim, fjala “arritje” nuk ka konotacion as pozitiv, as negativ. Arritje ka pasur, pastaj mund të jenë arritje, që ne i gjykojmë shumë të mira, ju i gjykoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të përbashkëta, të përbashkëta, patjetër!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, gjetje.

Luçiano Boçi – Tani, ju jeni tifozë të neutralitetit edhe te gjinitë këtu, nuk i ndani dot...

Arbjan Mazniku – Jo, jo, fjala “arritje” nuk ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Xhelal Mziu – Dua të shtoj dy gjëra.

Së pari, duhet të punojmë paralelisht, siç është, po themi, pjesa e financës, qoftë edhe ndarja territoriale apo gjëra të tjera, por që të punohet paralelisht dhe të kemi një produkt përfundimtar, besoj se edhe ju, në fjalën tuaj, dhe gjithsecili prej nesh mori referenca se si ne mund të shkojmë te Bashkimi Europian. Pra, ne duhet të marrim eksperiencën e tyre, pastaj atë se çfarë kemi pasur qasje pozitive apo negative në Shqipëri, dhe të shkojmë te produkti.

Unë propozoj se duhet me patjetër të përzgjedhim minimalisht dy apo katër vende të Bashkimit European, ku të shkojmë të shohim si funksionon pushteti vendor, cilat janë delegimet financiare që i bëhen pushtetit vendor dhe cili është vakumi midis legjislacionit që kemi, referuar me ato vende. E thashë, dy ose katër, që mund të jenë, po themi, dy të zgjedhur nga ne dhe dy nga ju apo një nga ju dhe një nga ne. Pra, duhet të jetë me patjetër.

Së dyti, duhet me patjetër të kemi aktor kryesor Kongresin e Autoriteteve Vendore, që është autoriteti më i lartë në Bashkimin European, ku edhe ne duam të aderojmë. Në këtë kontekst, unë them se duhet ta shfrytëzojmë me patjetër në momentet e para, për të ditur se ku duhet të shkojmë. Ne duhet të shkojmë te Bashkimi European; le të marrim referencat e tyre, për të kaluar më pas në terren dhe për të përdorur të gjithë aktorët e terrenit, duke filluar nga drejtuesit e bashkive, te këshilltarët, drejtuesit e qarqeve apo për të shkuar, po themi, te grupe të tjera interesi apo deri te qytetarët fundorë, për të parë të gjitha problematikat që janë krijuar, pa mohuar edhe pjesën e ekspertëve financiarë e të tjerë.

Kështu, do të doja që, qysh në krye të herës, ta përcaktojmë këtë marrje eksperience te vendet e BE-së. Nuk besoj se është koha për të bërë prapë një eksperiment të dytë, siç ishte ai i vitit 2014, por të bëjmë një draft përfundimtar, që të jetë unik me atë çfarë ka sot në Bashkimin European.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku – Jam dakord.

Nuk kam asnjë problem me logjikën për opsionet e vajtjes, për të parë eksperiencë diku. Shqetësimi i vetëm që kam në përgjithësi, është koha. Pra, duke parë elementin e gjësë, e kemi agjendën, por nuk na prish asnjë punë që të bëjmë diskutime me disa nga partnerët tanë dhe të shkojmë të shohim disa eksperiencë në ca vende për mënyrën se si funksionon, kompetencat që kanë, financimin... Pra, nuk jam absolutisht kundër, mund ta shohim si opsion. Dy, tre a katër, e diskutojmë, nuk kam ndonjë shqetësim në thelb me atë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kishit diçka?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Deputet – Besoj se patëm një diskutim të mirë sot dhe, po të vazhdojmë me këtë frymë bashkëpunimi, do të kemi një produkt të mirë. Por gojëdhënat thonë, gjithmonë gojëdhënat (“kazani”, thotë ai, që të mos ia vë atë emrin), se ju e keni gati një draft apo edhe këto

dokumentet: *Green Paper* dhe *White Paper*. Nëse i keni gati dhe keni në plan të shkoni tek ajo gjëja që keni gati, na e kurseni kohën; kursejmë disa shpenzime, që do të bëhen për këtë reformën, kursejmë ata miqtë tanë që do t'i thërrasim të vijnë nga andej për të na dhënë opinione, e ku ta di unë. Pra, në qoftë se jemi në këtë frymë, na i kurseni të gjitha këto formalitete dhe vazhdoni punën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

“Gojëdhënat”, thashë.

Nuk jemi dorëzuar. Unë thashë: gojëdhënat thonë se e keni gati. Tani, punë kazani është kjo punë, por në qoftë se është kështu...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku – Unë mendoj të mos merremi me gojëdhëna.

Pra, për herë të parë unë besoj shumë fort te një gjë, që quhet politikëbërje e bazuar te shifrat. Të bëjmë një analizë të mirëfilltë, të diskutuar, të bërë mbi një proces... Unë besoj se procesi nuk është qëllim në vetvete. Unë them se proceset e mira krijojnë produkte të mira. Pra, të bëjmë një proces të mirë, të kemi një produkt të mirë. Thënë këtë, opinione kemi të gjithë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj po them.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për të kaluar te pika tjetër, që ta mbyllim, dhe kjo është pika e fundit, propozimi, që e kam diskutuar edhe me bashkëkryetarin, është që ne, nga ana teknike e punës, të krijojmë dy grupe. Pra, grupi i ekspertëve të jetë me dy nivele: të kemi një nivel me 10 ekspertë të nivelit të lartë, me ekspertë që janë disi më multidisiplinarë, që janë si një grup analize dhe që e mbështesin me analizë, janë njerëz me eksperiencë pak më të gjatë pune, me ekspertizë më të gjatë, që lidhet me pushtetin vendor dhe që shërbejnë si një grup këshillimor permanent i komisionit, por me ekspertizë praktike, dhe një grup i dytë me 18 anëtarë, i cili ndahet në tri nëngrupe, ku grupi i parë është grupi i territorit dhe i qeverisjes, që merret me territorin dhe qeverisjen, grupi i dytë merret me funksionet, shërbimet dhe kompetencat, dhe grupi i tretë merret me financat vendore. Presupozohet që në tri grupet e nivelit të dytë të synojmë të ftojme njerëz që kanë ekspertizë specifike për fushat respektive dhe janë grupe që, gjithashtu, do të jenë përgjegjëse për shkrimin e propozimeve të kësaj fushe, eventualisht edhe për asistencën e komisionit për shkrimin e akteve në fushën respektive. Duke qenë se do të dalim me tri produkte, presupozohet që secili grup ka një objektiv shumë të qartë dhe të prekshëm, dhe është grup që ndihmon komisionin në procesin e tij.

Nëse jemi dakord me këtë, do t'ia bëjmë kërkesën eventualisht Byrosë dhe pas miratimit të saj nga Byroja, të miratojmë këtu emrat e ekspertëve dhe më pas t'i depozitojmë në mbledhjen e radhës. Kemi dakordësinë për këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E mbyllim? Kemi pikë tjetër?

Atëherë, t'i votojmë këto pika, edhe programin, edhe kërkesën, që t'i kemi edhe formale. Jemi dakord me...

Luçiano Boçi – Me ndryshimet e propozuara.

Arbjan Mazniku – Me ndryshimet e propozuara?

Luçiano Boçi – Po.

Arbjan Mazniku – Por nuk kishim ndonjë ndryshim.

Luçiano Boçi – Në terminologji, fjalën “gjetje”.

Arbjan Mazniku – Ah, në terminologji, po!

Luçiano Boçi – Jemi korrektë, domethënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe për fazën, edhe për të pasur më shumë kohë takimi me qytetarët.

Arbjan Mazniku – Patjetër, ato i vendosim, janë kollaj, por nuk janë pjesë të *timeline*-it. I shtojmë, nuk ka problem, por i vendosim edhe në agjendë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, por këto janë kolonat kryesore, pastaj rrugës...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është te kjo. Do të miratojmë plane mujore praktike. Domethënë, nuk është ai problemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

E miratojmë?

Ka ndonjë që është kundër? Ndryshime?

MBYLLET MBLEDHJA